

Nishani "harron" të dekretojë Rrugën e Arbrit

▶ FAQE 7

[SHQIPTARJA.com]



ÇMIMI 30 LEKË | VITI V - NR.116 | E MËRKURË, 20-05-2015 | www.shqiptarja.com

Rifillojnë privatizimet

JA 85 PRONAT E PARA SHTETERORE QE SHITEN

Qeveria ka vendosur të rinisë
procesin e privatizimit të gjithë aseteve.
Shiten shkolla, reparte ushtarake,
magazina deri edhe tunele

▶ FAQE 2-3



ELHAIDA DANI SHKON NË FINALEN E EUROVISIONIT

Shqipëria kualifikohet e
para me këngën "I'm Alive".
Prezantim i shkëlqyer i
këngëtares sonë

▶ FAQE 15

Mjekët, kush rrezikon të largohet nga puna, kriteret

1450 mjekë, farmacistë dhe
stomatologë që nuk kanë
asnjë kredit dhe ata që nuk
kanë mbledhur numrin e
kërkuar, u rrezikohet vendi i
punës dhe licenca

▶ FAQE 4



"TRADHETIA", ROMANI QE DYSHOHEJ SE JEPTE TE DHENA SEKRETE PER UDB-në

50-vjetori i krijimit të veprës së Kapllan Resultit. Si u
shkruajt në vitet e internimit në Çermë

▶ FAQE 18-19



Blue
Medical
Center

Vizita, Analiza & Diagnostikim
Të garantuara
sipas protokolleve të
mjekësisë bashkëkohore
nga Blue Medical Center

Të parandalosh, më mirë se të kurosh!

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë
Tel: + 355 4 2370 668

Cel: +355 66 20 90 008
Email: info@bmc.al, www.bmc.al

Në shitje pronat shtetërore, zbardhen 85 objektet e para

Qeveria privatizon pronat shtetërore, si dhe aksionet e shoqërive publike e strategjike

LORENC RABETA
TIRANE

Janë 85 objektet shtetërore të nxjerra në shitje në kuadrin e privatizimeve të parajalimëruara që nga vitet 2014. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, përmes dy paketash, ka bërë publike asetet e nxjerra në shitje, si dhe procedurat që duhet të ndiqen nga të interesuarit për t'u përfshirë në ankandet për blerjen e tyre. Ministria ka publikuar gjithashtu edhe bazën ligjore ku do të bazohet privatizimi i shoqërive në likuidim, i shoqërive jo strategjike, dhe atyre strategjike. "MZHETS ka përgatitur paketën e parë të privatizimit të asetëve shtetërore, informacion që në mënyrë transparente i bëhet prezent çdo të interesuari që do të kërkojë të dhëna me interes dhe në pëmbushje të plotësisht të ndjekjes së të drejtave të tij që lidhen me pronësinë" thekson Ministria përmes një njoftimi zyrtar.

PRIVATIZIMET

Që nga viti 2014, qeveria planifikoi të privatizojë thuhet çdo kompani të rëndësishme publike ende në pronësi të shtetit. Në programin ekonomik e fiskal, Këshilli i Ministrave bëri publik projektin për privatizimin e të gjitha asetëve në sektorin jostrategjik, por veçanërisht shitjen e aksioneve në kompanitë strategjike si "Albpetrol", "ARMO" apo "Albtelecom". Sipas dokumentit, është planifikuar privatizimi i të gjitha asetëve dhe aksioneve shtetërore të shoqërive në sektorët jostrategjikë. Vlera e përgjithshme e këtyre asetëve dhe e aksioneve shtetërore është përllogaritur në një vlerë prej 5 milionë eurosh.

PRIVATIZIMET STRATEGJIKE

Ndërkohë që, shumë më të kështueshme janë privatizimet në sektorët strategjikë. Privatizimi i paketës së mbetur të "Albtelekom" sh.a.: Shitja e paketës së zotëruar nga shteti është planifikuar për vitin 2014. Sipas Qeverisë, paketa e mbetur prej 16,768,366 për qind të aksioneve, është vlerësuar me një vlerë prej 2 500 milionë lekësh ose 18 milionë eurosh, specifikohet në dokument. Privatizimi i paketës së mbetur në "ARMO" sh.a.: Shitja e paketës shtetërore është planifikuar të realizohet gjatë vitit 2015.

Në "ARMO" sh.a., shteti zotëron rreth 14,9 për qind të aksioneve me një vlerë të përllogaritur në rreth 22 milionë euro. Privatizimi i pjesës së mbetur në "OSSH" sh.a.: Shoqëria është privatizuar në vitin



PRECEDENTËT


Dy fazat e privatizimeve të pronave shtetërore

Në Shqipëri, historia e privatizimeve mund të ndahet në dy faza: Periudha e parë, 1993-1999, ku të ardhurat nga privatizimet kanë qenë në një masë shumë të ulët. Ato lidheshin kryesisht me ndërmarrje apo asetet e vogla. Dhe periudha e dytë, 2000-2010, gjatë së cilës u mundësua privatizimi i disa shërbimeve shumë të rëndësishme. Në këtë mënyrë, të ardhurat nga privatizimet u shndërruan në një zë të rëndësishëm në përbërësimin e Deficitit të Buxhetit. Në këtë mënyrë, të ardhurat nga privatizimet u shndërruan në një zë të rëndësishëm në përbërësimin e Deficitit të Buxhetit.

ASETET

Ministria ka publikuar gjithashtu edhe bazën ligjore ku do të bazohet privatizimi i shoqërive në likuidim, i shoqërive jo strategjike, dhe atyre strategjike, si dhe procedurat përkatëse

2009. Janë shitur 76% e aksioneve dhe aktualisht shteti zotëron në këtë shoqëri 24% të aksioneve. Pjesa e mbetur e aksioneve prej 24% dhe me një vlerë të përllogaritur në rreth 32 milionë euro është planifikuar të shitet gjatë vitit 2016. "Privatizimi i 'Albpetrol' sh.a.: Gjatë periudhës 2015 - 2016 është planifikuar shitja 100 për qind e paketës shtetërore të zotëruar nga shteti. Kapitali i regjistruar i kompanisë "Albpetrol" sh.a. vlerësohet në rreth 95 milionë euro". Vetë Kryeministri Edi Rama, Konfirmoi pak javë më parë se renda vitit qeveria do të ketë gati procedurat për privatizimin e "Albpetrol". Sipas tij, 2015 do të jetë dhe viti i përfundimit të një procesi të stërzgatur privatizimi të shoqërisë shtetërore "Albpetrol", për të cilin po përgatiten dokumentat për privatizimin në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.



PAKETA E PARË E ASETËVE SHTETËRORE TË PËRFSHIRA NË PROCEDURËN E PRIVATIZIMI

Nr.	Emertimi i objektit	Qarku/Rrethi
1	Arka e Kursimit Shkodër	Shkodër
2	Ish Muze, në Sheper, Gjirokastrë	Gjirokastrë
3	Ish Shkolla e Mesme në Nivan, Gjirokastrë	Gjirokastrë
4	Magazina e Farmacive Elbasan	Elbasan
5	Objektet 8,9,10,11,12,13 te Ish N/Repart Ushtarak AKA 2825, në Kala, Berat	Berat
6	Tunele Tapizë	Tiranë
7	Librari Fier	Fier
8	"Garazh" Ish UPN Kuçovë	Berat
9	"Zyra te Permbarimit Gjyqesor " Berat	Berat
10	Ish Oficinë, Bibliotekë, Magazinë, Morg dhe Lavanteri, Shkodër	Shkodër
11	Çerdhe 1 Maj	Shkodër
12	Ish Dogana, Stacioni i Trenit	Shkodër
13	Banaku i Lokal Sopoti Librazhd	Elbasan
14	Garazhe të Ish qendrës Ekonomike të Arsimit në Librazhd	Elbasan
15	"P.P.K.Llongo" në Gjirokastrë.	Gjirokastrë
16	Depo në Libonik	Korçë
17	Ndërtesa e grupit Spatharë	Shkodër
18	Kantina e Verës Milot	Lezhë
19	Kinema 13 Shtatori	Berat
20	Ish zyrat e Gjendjes Civile Çërravë	Korçë
21	Parkimi i Automjeteve	Tiranë
22	"Oficina e ish Ndërmarrjes Gjeologjike Burrel	Dibër
23	Ish ndërmarrja e drithit (ish banesë shtetërore)	Elbasan
24	Librari "Kuvendi"	Lezhë
25	Zyrat e ish ndërmarrjes Komunale	Berat
26	Ish-oficina e ekspeditës	Gjirokastrë
27	Ish Parku Automobilistik i mallrave	Gjirokastrë
28	Arkivi i filmit, magazina kostumesh, Atelie e vjetër	Tiranë
29	Garazh, ish SMT në Gramsh	Elbasan
30	Pikë karburanti centrale	Vlorë
31	Ndërtesa e Grupit Qafë-Qele	Shkodër
32	Ndërtesa e Grupit Puke "Kroi I Zojës"	Shkodër
33	Magazinë (Tetojë) Shkozet (ish DFE Durrës)	Durrës
34	Depo drithi ne Trebinje-Pogradec	Korçë
35	Posta e Policise Kufitare Katund	Gjirokastrë
36	Librari në fshatin Sinanaj, Tepelenë	Gjirokastrë
37	Ndërtesa e grupit Bogë	Shkodër
38	"Dyqan Industrial" Potom Skrapar	Berat
39	"Ish-Zyrat e Komunes" ne Vrisera	Gjirokastrë
40	"Ish-Ambulanca", kati përdhe ne Vrisera	Gjirokastrë




Në Tiranë është nxjerrë në shitje godina 1 katëshe e sharrave prerëse të kampioneve, një ambient i ish Shtëpisë Botuese Naim Frashëri, magazina e reparitit të montimit, por edhe tunelet në Tapizë

OBJEKTET



Shiten shkolla, muze, reparte, magazina deri edhe tunele

Duket se gjithaçka e mundshme është përfshirë në procesin e privatizimit: Ja procedurat



LORENC RABETA
TIRANË

Shkolla, reparte ushtarake, mensa, magazina, ish reparte artizanale, ofiçina, kantina, zyra: duket se gjithaçka e mundshme është përfshirë në procesin e privatizimit. Në Tiranë është nxjerrë në shitje godina 1 katëshe e sharrave prerëse të kampioneve, një ambient i ish Shtëpisë Botuese Naim Frashëri, Magazina e reparitit të montimit, por edhe tunelet në Tapizë. Të njëjtin fat ka pësuar edhe Arka e Kursimit Shkodër, Ish Muzeumi, në Sheper të Gjirokastrës, si dhe ish shkolla e Mesme në Nivan po të këtij qarku. Në shitje është gjithashtu një depo në Libonik të Korçës, Kantina e Verës Milot, Kinema 13 Shtatori në Berat apo Ish zyrat e Gjendjes Civile Çërravë.

PROCEDURAT

Kërkesa për privatizimin e një asemi shtetëror mund të drejtohet në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes apo në institucionin përkatës që ka në administrim/ pronësi objektin që kërkon të privatizohet, e cila mund të bëhet nga pronari

i trullit ose çdo person tjetër/institucion i interesuar për blerjen e asetit. Kërkesa duhet të përmbajë emërtimin e saktë të Institucionit që i drejtohet kërkesa. "Emërtimin e saktë të objektit dhe vendndodhjen e objektit që kërkon të privatizohet. Të dhëna të tjera në lidhje me këtë objekt (nëse ka, p.sh. varësinë administrative të tij, funksionin që ka pasur, gjendjen aktuale të objektit, etj.) Identitetin dhe adresën e saktë të personit që drejton kërkesën. Çdo dokument apo të dhënë tjetër të vlerësuar nga kërkuuesi bashkëngjitur kërkesës" thekson Ministria e Zhvillimit Ekonomik në njoftimin zyrtar.


KËRKESA

Nëse kërkesa për privatizim bëhet pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes: MZ-HETS pas shqyrtimit të kërkesës së bërë nga i interesuari, i kërkon strukturës administrative të objektit prononcin për privatizimin e tij. Nëse institucioni administrues përgjigjet pozitivisht për privatizimin e objektit të kërkuar, atëherë Ministri i MZHETS miraton privatizimin e objektit dhe urdhëron fillimin e procedurës për vlerësimin e objektit me qëllim privatizimin.

DEFICITI/VITI 2000, 8.9 MILIARDË LEKË TË ARDHURA

Privatizimet, shpëtimtaret e buxhetit të shtetit në vite

Të ardhurat nga privatizimet në vite janë parë si një element shumë i rëndësishëm për arkën e shtetit. Viti 2000 ishte i pari që shënoi të ardhura të larta nga privatizimet, me 8.9 miliardë lekë, duke financuar 22% të Deficitit. Duhet theksuar se viti 2000 ishte një vit i vështirë për Buxhetin, pasi të Ardhurat Totale të tij ishin më të ulta edhe sesa Shpenzimet Korrente. Kjo do të thotë se jo vetëm investimet janë financuar nga borxhi dhe privatizimet, por edhe një pjesë e shpenzimeve korrente. Gjithsesi, ky vit shënoi gjithashtu edhe privatizimin e parë të rëndësishëm në vend, atë të Bankës Kombëtare Tregtare. Në vitin 2001, privatizimet u rritën me 43%



Deficiti

Në 2001, privatizimet u rritën me 43% dhe financuan 30% të Deficitit, ndërkohë që dy vitet pasues patën një mesatare të ulët

dhe financuan 30% të Deficitit të atij viti, ndërkohë që dy vitet pasues patën një mesatare të ulët. Viti 2004 shfaqti sërish të ardhura të larta nga privatizimet. Përveç të tjerave, 2004-a lidhet edhe me privatizimin i ish-

Bankës së Kursimeve, e cila mundësoi përballimin e një pjese të deficitit si dhe reduktimin e borxhit publik. Në vitet 2005 dhe 2006 u rikthye pushimi i procesit, ndërkohë që vetëm në vitin 2007 u realizua privatizimi i shoqërisë Albtelekom. Viti 2008 u pasua me një rënie 58% të të ardhurave të privatizimit. Gjithsesi, ato ishin në një masë të kënaqshme. Ishte tashmë radha e kompanisë ARMO për t'u transferuar drejt sektorit privat. Viti 2009 shënoi pikën më të lartë të të ardhurave nga privatizimet. Rreth 25 miliardë lekë shërbyen për financimin e deficitit dhe padyshim që shiqa e 76% e aksioneve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes s.h.a. ishte ngjarja kryesore e vitit.

PAKETA E DYTË E PRIVATIZIMEVE		
Nr.	Emërtimi i objektit	Qarku/Rrethi
1	"Ish Shkolla 8 vj Lapardha 1", Berat	Berat
2	"Ish Shkolla Fillore" Veterik, Berat	Berat
3	"Agjencia" e parkut të udhetarëve Berat.	Berat
4	Garazhe Fier	Fier
5	"Mensë, zyra, magazinë", Buçimas	Korçë
6	NFK-Ndërfushas, Rrëshen	Lezhë
7	Ndërtesë e Grupit Tamarë Sektori Shkodër	Shkodër
8	Sera & magazina tek insituti i patates	Tiranë
9	Disa ambiente në Katin e Parë të Godinës 2 katëshe, e SHGJSH	Tiranë
10	Godine 1 katëshe e sharrave prerëse të kampioneve	Tiranë
11	Magazina e Reparitit të Montimit	Tiranë
12	Objekti "Ambient", i ish Shtëpisë Botuese Naim Frashëri	Tiranë
13	Farmacia KLOS	Dibër
14	Ish depo karburanti Sulç	Dibër
15	5 Objekte të Drejtorisë Pyjore Dibër	Dibër
16	Objekti nr. 104, Uzina 12 & Ni-Co.	Elbasan
17	Reparti i Marangozisë Ersekë	Korçë
18	"3 Depo + peshorja" e rep.101/k Lapardha Berat	Berat
19	"Godina e gjykates se rrethit" Skrapar	Berat
20	"N.Sh.N " (ish SHISH-i Kuçovë)	Berat
21	"Agjencia Mbolan"	Berat
22	Magazinat e Vjetra, Këndi kuq	Dibër
23	Peshore Shupenzë	Dibër
24	Ambjente Artizanale Peshkopi	Dibër
25	Objekti Ish Kooperat.Bujqësore"Partizani" në Fushë-Krujë	Durrës
26	Ish Zdrukhtari për shërbime funerale në Gramsh	Elbasan
27	Objekti nr. 124 (Stacioni i aspiratorëve të gazit)	Elbasan
28	Ish Magazina e Spitalit Gramsh	Elbasan
29	Garazhe në Elbasan	Elbasan
30	Bodrum në lagjen "Kongresi i Elbasanit" në Elbasan	Elbasan
31	Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Këlcyrë	Përmet
32	"Posta e Policisë Kufitare Mesare", Përmet	Përmet
33	"Shkolla e Vjetër Çarçovë", Përmet	Përmet
34	Objekte:"Ofiçina Qendër", "Zyrë e Sektorit","Depo & Zdrukhtari","Magazina" dhe "Garazhe"	Tepelenë
35	"Zyrat e Ish-Kooperativës" në Golem	Gjirokastrë
36	"Pulari Reparti ushtarak 1015"	Pogradec
37	"Objektet PPK Peshkëpi"	Pogradec
38	"Dega Arkivore Kolonjë	Korçë
39	Ndertesë e Grupit Bushat	Shkodër
40	Agjensia e Kredive	Vlorë
41	Reparti i Axhusterisë	Fier
42	Ish ndërmarrja Gjeologjike	Vlorë
43	Garazh	Pogradec
44	Librari	Berat
45	Godine 1 katëshe	Korçë



DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Më shumë se 200 mjekë pritet të largohen nga puna në muajt e ardhshëm. Mos marrja e asnjë krediti gjatë 5 viteve të programit të Edukimit në Vazhdim, do të bëjë që këta mjekë të largohen nga vendi i punës. Jo vetëm mjekët por dhe 70 farmacistë dhe rreth 390 dentistë rrezikohet t'u hiqet licenca, pasi rezultojnë me 0 kredite. Në rrezik janë dhe 1450 mjekë, dentistë dhe farmacistë, të cilët nuk kanë mbledhur numrin e kërkuar të krediteve gjatë 5 viteve dhe duhet të marrin provimin e ricertifikimit për tu mos larguar nga puna. Ja 11 pyetjet që shpjegojnë se çfarë është programi i Edukimit në Vazhdim dhe provimi i ricertifikimit.



Mjekët, kush rrezikon të largohet nga puna, ja kriteret

1450 mjekë, farmacistë dhe stomatologë që nuk kanë asnjë kredit dhe ata që nuk kanë mbledhur numrin e kërkuar, u rrezikohet vendi i punës dhe licenca

vazhdueshëm profesional të punonjësve të shëndetësisë. Ai ka dy objektiva kryesorë: Të nxisë punonjësit e shëndetësisë që të ndjekin aktivitetet e edukimit në vazhdim në përbushje të nevojave të tyre individuale, në funksion të praktikave më të mira profesionale dhe cilësisë në të lartë të shërbimit ndaj pacientit. Të dokumentojë dhe

regjistrojë kreditet e përfutuara nga aktivitetet e edukimit në vazhdim në funksion të ricertifikimit të punonjësve", - thuhet në udhëzuesin e Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim. Në të ardhmen programi i ricertifikimit do të integrohet në procesin e rilicencimit të punonjësve të shëndetësisë.

2015 për të deklaruar kreditet që kishin grumbulluar. Pas kësaj date u vendos që ata mjekë, farmacistë dhe dentistë që nuk kishin plotësuar numrin e kërkuar të krediteve do të kalonin në provim ricertifikimi.

Çfarë është provimi i ricertifikimit dhe kush do të pezullohet?
Provimi i ricertifikimit kryhet

Çfarë parashikon udhëzimi nëse profesionistët e shëndetësisë nuk mbledhin kreditet e kërkuara?

Profesionistët, që nuk arrijnë të mbledhin numrin e përgjithshëm prej 150 kreditesh për ciklin e parë të programit të ricertifikimit deri në 31 dhjetor 2014 ose numrin e përgjithshëm prej 250 kreditesh për ciklet pasuese, do t'i nënshtrohen një provimi njohurish dhe kompetencash. Profesionistët, të cilët dështojnë në provimin e parë ose, për arsye të ndryshme, nuk i nënshtrohen atij, kanë mundësinë që brenda 6 muajve nga përfundimi i ciklit të programit të ricertifikimit t'i nënshtrohen një provimi të dytë. Në rastet kur profesionisti dëshiton edhe në provimin e dytë ose nuk i nënshtrohet atij, atëherë profesionistit mund t'i pezullohet kontrata me institucionin ku është punësuar deri në momentin e kalimit me sukses të provimit.

Çfarë ndodh me profesionistët e shëndetësisë që plotësuan kreditet dhe ata që nuk i plotësuan?

Ministria e Shëndetësisë dhe QKEV u la afat të gjithë profesionistëve të shëndetësisë deri në 30 prill

për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe kompetencave të profesionistëve që nuk janë angazhuar plotësisht në edukimin e tyre në vazhdim gjatë një cikli ricertifikimi dhe për të garantuar përpunjen me kërkesat bashkëkohore të praktikës profesionale. Përmbajtja e provimit hartohet nga Komisioni i Provimit të Ricertifikimit në përputhje me fushën e veprimtarisë profesionale dhe me zhvillimet e reja shkencore në këtë fushë. Urdhri Profesional përkatësisht UMSH, UFSH dhe USSH është përgjegjës për pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të gjithë atyre profesionistëve të cilët në përfundim të ciklit të ricertifikimit kanë 0 kredite dhe atyre që nuk e kanë kryer me sukses provimin e ricertifikimit në përfundim të periudhës 6 mujore në dispozicion. Urdhri Profesional është përgjegjës për ridhënien e lejes së ushtrimit të profesionit pas dorëzimit të dëshmisë së kryerjes me sukses të provimit të ricertifikimit.

Kush nuk e jep provimin e ricertifikimit?

Përrjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin: Profesionisti i punësuar në shërbim publik shëndetësor, i cili për 2 vjet ose më pak arrin moshën e pensionit dhe profesionisti, i cili ka marrë lejen e ushtrimit të profesionit për herë të parë 2 vjet përpara përfundimit të ciklit të ricertifikimit.

Kur do të zhvillohet provimi dhe çfarë do të përmbajë?

Provimi i ricertifikimit zhvillohet gjatë periudhës Prill – Tetor të vitit pauses të secilit cikël ricertifikimi. Fushat ku do testohen 3 profesionet e shëndetësisë janë: Obstetrike, Gjinekologji, Dermatologji, Nefrologji, Psikiatri, Kirurgji e përgjithshme, Imazheri, Semundjet Infektive, Endokrinologji, Pneumologji, Ortopedi, Mjeku Familjes, Kardiologji, Pediatri, Mjekesi Urgjence, Farmaci, ORL, Anestezia Reanimacion, Hematologji, Stomatologji

Si bëhet regjistrimi për në provimin e ricertifikimit?

Profesionisti i cili njoftohet për detyrimin për të kryer provimin e ricertifikimit duhet të bëjë një kërkesë me shkrim për t'u regjistruar për provim pranë AKP. Kërkesës për regjistrim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtëm: fotokopje e kartës së identitetit, fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit dhe fatura e pagesës për provimin e ricertifikimit. Dokumentacioni dorëzohet vetëm në regjistrimin e parë dhe shërben edhe për regjistrimin pasardhës në rast përsëritjeje.

A mund të rjepet provimi dhe a ka mundësi për ankesa ndaj rezultatit?

Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të përsërisë një herë provimin e ricertifikimit brenda periudhës 6 mujore të përcaktuar për këtë provim dhe në një kohë të dytë jo më shumë se 5 herë. Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të kontestojë rezultatit me një ankesë me shkrim pranë AKP-së brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultatit. AKP-ja shqyrton ankesën dhe kthen përgjigje të argumentuar brenda 30 ditëve. Në rastet kur AKP-ja sugjeron rivlerësimin e rezultatit, këkohet vendimi i Komisionit të Provimit të Ricertifikimit.

Çfarë është programi i ricertifikimit?

Programi i Edukimit në Vazhdim organizohet në cikle 5-vjeçare. Cikli i parë filloi në janar 2010 dhe përfundoi në dhjetor 2014. Profesionistët u përfshijnë në këtë program janë mjekë, stomatologë dhe farmacistë, shtetas shqiptarë dhe të huaj, që ushtrojnë profesionin e tyre në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi, në institucione publike ose private të kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor dhe ata të institucioneve akademike shëndetësore.

Sa kredite duhet të mbledhinin "bluzat e bardha"?

Në ciklin e parë të programit të ricertifikimit profesionistët e përfshirë duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 150 kredite në 5 vjet për mjekët dhe 100 kredite për farmacistët dhe stomatologët. Në ciklet që vijojnë numri i krediteve të detyrueshme për t'u mbledhur brenda ciklit pesëvjeçar do të jetë 250.

Si i fitojnë kreditet mjekët dhe farmacistët?

Mjekët, farmacistët dhe stomatologët i fitojnë kreditet duke marrë pjesë në aktivitetet shëndetësore, të cilat janë të akredituara nga Qendra e Edukimit në Vazhdim. Aktivitetet mund të jenë konferenca shkencore, seminare apo trajnime. Qëllimi i programit të ricertifikimit është që mjekët të jenë në koherencë me zhvillimet që po pësojnë fushat e mjekësisë. Aktivitetet lidhen drejtpërdrejt me specialitetin përkatës të profesionistit.

Çfarë synon programi i ricertifikimit?

Programi i ricertifikimit është hartuar për të mbështetur, fuqizuar dhe promovuar zhvillimin e

RREGULLORJA



Urdhri Profesional është përgjegjës për pezullimin e lejes së ushtrimit të profesionit të gjithë atyre profesionistëve të cilët në përfundim të ciklit të ricertifikimit kanë 0 kredite dhe atyre që nuk e kanë kryer me sukses provimin e ricertifikimit në përfundim të periudhës 6 mujore në dispozicion

PROVIMI



Fushat ku do testohen 3 profesionet e shëndetësisë janë: Obstetrike, Gjinekologji, Dermatologji, Nefrologji, Psikiatri, Kirurgji e përgjithshme, Imazheri, Semundjet Infektive, Endokrinologji, Pneumologji, Ortopedi, Kardiologji, Pediatri, Mjekesi Urgjence, Farmaci, ORL, Anestezia Reanimacion etj.

& Pyetje Përgjigje

JUXHIN MUSTAFARAJ
TIRANË

Kryetari i Kuvendit, njëkohësisht Kryetar i LSI-së Ilir Meta dhe gjatë një takimi me të rinjtë e qytetit të Shkodrës kërkoi mbështetjen e tyre për kandidatën e Aleancës për Shqipërinë Europiane Ketë Bazhdari. Ndryshe nga takimet e tjera elektorale ku aleatët Rama e Meta shfaqen përkrah njëri-tjetrit, kryetari i LSI-së vendosi të zhvillojë një takim tjetër mbështetës para prezantimit zyrtar që do t'i bëjë kandidatës Ketë Bazhdari dhe programit të saj pak ditë më vonë. Kandidatja e mazhorancës për Shkodrën, mund të konsiderohet fare mirë si e përkëdhelura e shumicës në këto zgjedhje pasi që nga shpallja e kandidaturës së saj dhe në vazhdim, Rama e Meta kanë promovuar në vazhdimi Bazhdarin si simbolin e mazhorancës në këto zgjedhje. Ja 4 pyetjet që shpëgojnë insistin e mazhorancës për të fituar Shkodrën.



Beteja e mazhorancës për të fituar Bashkinë e Shkodrës

Takimet e shpeshta elektorale të Ramës e Metës në kryeqendrën e veriut. Sulmet e ish-kryeministrit Berisha dhe mbështetja e Doshit për Bazhdarin

Çfarë zhvillimesh pati brenda mazhorancës të cilat e fokusuan betejën elektorale në Shkodër?

Në fillim të muajit mars kur Rama e Meta kishin filluar të diskutonin mes tyre emrat e kandidatëve të përbashkët që do të garonin në 61 njësitë e reja vendore, brenda PS-së pati një zhvillim mjaft të rëndësishëm. Në mbledhjen e grupit të Partisë Socialiste të datës 2 mars, kryeministri Edi Rama vendosi përjashtimin e deputetit të Shkodrës Tom Doshi, pas asaj që ai e konsideroi çënim të qeverisë dhe PS-së, referuar deklaratave të këtij të fundit. Ndonëse kreu i qeverisë Rama në çdo dalje u shpreh me bindje se ky largim nuk do të ndikonte në zgjedhjet vendore, të gjithë në PS dhe brenda mazhorancës ishin të bindur se ky vendim, sado i detyrueshëm që ishte për shkak të rrethanave që u krijuan do të kishte kosto elektorale. Tom Doshi ishte deputeti që prishur balancat elektorale në Shkodër për të djathtën që nga viti 2005 kur që zgjedhur deputet. Në qarkun që njihet si bastion i së djathtës, PS arriti të dalë fitues në zgjedhjet parlamentare të 2013 duke fituar 6 mandate kundrejt 5 mandateve të fituara nga PD. Edhe vetë kryeministri Rama në të gjitha daljet e tij të mëparshme ka shprehur publikisht se rezultatet e mira të PS-së në Shkodër janë arritur edhe falë ndikimit të madh dhe mbështetjes së plotë që gëzonte në qarkun e Shkodrës, deputeti Tom Doshi. Kur kishin ngelur edhe dy muaj nga zhvillimi i zgjedhjeve vendore, mazhoranca duhet të përzgjidhte një kandidatë fituese dhe që të mbulonte peshën elektorale që do të krijohej nga largimi i deputetit Tom Doshi.

Pse u përzgjedh Bazhdari dhe çfarë reagimi patën aleatët e LSI-së për kandidaturën e saj?

Pavarësisht emrave të përfolur

për të përfaqësuar Partinë Socialiste dhe mazhorancën, kryeministri Edi Rama vendosi që t'ia besonte një femre betejën elektorale në kryeqendrën e veriut. Ketë Bazhdari ishte e përzgjedhura e Ramës, vendim të cilin ai ia komunikoi deputetëve të Shkodrës në takimin e zhvilluar me ta në 30 mars në PS. Bazhdari për disa vite kishte qenë kryetare e PS-së në Shkodër dhe gjithashtu kontributet e saj

për ardhjen e PS në pushtet kishin qenë të mëdha, falë angazhimit që ajo pati si drejtuese e grupit të punës për hartimin e programit për të përdjekurit politikë. Vendimi për kandidimin e Bazhdarit, duket se ishte rënë më parë edhe dakort me aleatin e LSI-së Ilir Meta. Fillimisht ishte kryetari i grupit të LSI-së, Petrit Vasili i cili e konsideroi kandidaturën e Bazhdarit si të shkëlqyer ndërkohë që 3 ditë më

pas në krah të saj kryetari i LSI-së Ilir Meta do e quante kandidatën e mazhorancës si zgjedhjet e duhur. Ndërkohë pak ditë më pas në një intervistë televizive, Meta do ta cilësonte betejën për Shkodrën si më të fortën dhe më të bukurën e këtyre zgjedhjeve për shkak të shumë ngjarjeve të ndodhura së fundmi dhe gjithashtu sepse në përballje ishin dy femra. Për Metën, kandidatura e Bazhdarit ishte më

ZGJEDHJET

Bashkia e Shkodrës mori peshën më të rëndësishme të këtyre zgjedhjeve vendore për të majtën pas përjashtimit nga PS të deputetit Tom Doshi, ndërkohë që ky i fundit ka ofruar edhe mbështetje

përfaqësuesja jo vetëm për të majtën por për të gjithë koalicionin.

Cila ishte mbështetja që qeveria i dha kandidatës dhe cila ishte mënyra e promovimit të saj?

Menjëherë pas prezantimit të kandidatës së Bazhdarit, qeveria nisi të prezantonte njëra pas tjetrës projektet e reja për Bashkinë e Shkodrës. Kryeministri Rama ashtu siç kishte premtuar do të kërkonte që pesha e deputetit të përjashtuar Doshi të mos ndihej aspak, ndërkohë që do të kërkonte t'i merrte bashkinë që nuk e ka pasur asnjëherë e majta, Partisë Demokratike. Projekti më madhor dhe që do ta kthejë Shkodrën në kryeqendrën e Shqipërisë sa herë që do të ketë ndeshje kombëtarja do të jetë ndërtimi i stadiumit të ri. Restorimi i "Loro Boriçit" pritet t'i japë një fytyrë të re qytetit të Shkodrës, ndërkohë që pritet të rris kreditetin dhe të vetë kandidatës së propozuar nga mazhoranca. Gjithashtu edhe falë biznesit të saj fazon dhe projekteve për çështjen e punësimin, mazhoranca ka kërkuar mbështetje të pakursyer për Bazhdarin.

Çfarë qëndrimi ka mbajtur opozita për këtë garë dhe kandidaturën e Bazhdarit?

Për ta cilësuar garën e Shkodrës si më të rëndësishmen edhe për opozitën, ish-kryeministri Berisha publikoi në media përgjime të mbledhjeve të kryeministrit Rama e Meta në Shkodër me strukturat. Pas kësaj Berisha sulmoi edhe publikisht në parlament Ketë Bazhdarin, duke hedhur aludime të forta për pasurinë e krijuar prej saj. Për këtë çështje kandidatja e PS-së depozitoi edhe kallëzime në Prokurori për ish-kryeministrit Berisha duke e paditur për shpifje. Pak ditë më pas Berisha sërish sulmoi kandidatën e mazhorancës në Shkodër, duke ngritur pretendimin se LSI në këtë qytet po shiste vota në këmbim të veshjeve dhe kuponave 50 mijë lekësh. Edhe për këtë rast, LRI e këtij qyteti ngriti një kallëzim për Berishën. Ditën e djeshme ishte PD e Shkodrës ajo që njoftoi vjedhjen e zyrës së saj elektorale në këtë qytet, për të dëshmuar se edhe pse pa nisur ende zyrtarisht fushata elektorale, do të jetë bashkia e lakmuar për të majtën dhe prova e forcës për të djathtën. Për çudinë e të gjithëve dhe jashtë çdo pritsshmërie të Partisë Socialiste, ish-deputeti i saj Tom Doshi dy ditë më parë deklaroi se do të ofrojë mbështetjen e tij për Ketë Bazhdarin nëse ajo do e kërkojë këtë gjë. Në fjalën e tij Doshi u shpreh se vijon të gëzojë mbështetjen e elektoratit të majtë në Shkodër pavarësisht përjashtimit të tij. Deklarata e deputetit të përjashtuar nga PS, ishte një sinjal i pastër edhe për demokratët për të treguar se ndikimi i Doshit në Shkodër do shkojë në favor të së majtës dhe kandidatës Ketë Bazhdari.

Opozita

Shkodra është vlerësuar si beteja e forcës dhe për opozitën, e cila sakrifikoi mandatin e deputetes Voltana Ademi për ta përfshirë në garë ndërkohë që ish-kryeministri Berisha ka nisur një seri sulmesh ndaj kandidatës së mazhorancës Bazhdari



Mbështetja

Kryeministri Rama ashtu siç kishte premtuar do të kërkonte që pesha e deputetit të përjashtuar Doshi të mos ndihej aspak ndërkohë bashkë me Metën do të kërkojnë t'i marrin bashkinë që nuk e ka pasur asnjëherë e majta, Partisë Demokratike.

STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT 1 PËR:

"Apartament", me sip 86 m2, me nr.pasurie 3/77+1-20, Z.k.8632, Volumi 9, faqe 149 me adresë Lagjia Besëlidhja Lezhë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **26,400 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind) Euro.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **27.05.2015, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla.1, Kati. 2, Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni
cel.0693041355, 0696334695 email: speed.solution@yahoo.com

Prezantohet e-Albania, Rama: Mbi 150 shërbime online

Aplikacion në internet për faturat e energjisë, patentat me pikë, regjistrimin e bizneseve

LORENC RABETA
TIRANË

Nga dje, pagesa e faturave të energjisë elektrike, regjistrimi i biznesit, taksat e makinave, patentat me pikë, bashkë me rreth 150 shërbime të tjera, do të mund të kryhen përmes internetit me anë të aplikacionit e-Albania. Kryeministri Edi Rama i pranishëm në prezantim, tha se ky aplikacion mund të përdoret edhe nëpër celularë duke lehtësuar qytetarët dhe bizneset, ndërkohë që përbën një armë shumë efektive kundër korrupsionit. "Sot kemi bërë një punë kolosale duke arritur që nga 12 shërbime që kishte portali në 2013, të kemi mbi 150 shërbime dhe duke krijuar kushtet që në një kohë të shpejtë 89 shërbime të reja të shtohen dhe në kornizën e ndërveprimit të arrijnë 30 institucione. Nëse bazat e të dhënave nuk janë funksionale është e kuptueshme që kompjuteri më i sofistikuar në botë nuk ka çfarë të japë përderisa ushqimi vjen nga baza e të dhënave. Dua të nënvizoj se ky portal është pjesë e një projekti që lidhet me programin e kalimit nga një shtet që shërben me njerëz në një shtet që shërben online" theksoi Rama.

QENDRA
Por paralel me këtë projekt, kryeministri Rama tha se



është duke u punuar edhe për krijimin e një qendre të vetme që ofron të gjitha shërbimet online. "Ndërkohë jemi duke punuar intensivisht me një ekspertizë të lartë ndërkombëtare dhe me mbështetjen e Bankës Botërore me të cilën kemi ngritur një skuadër të përbashkët për të mundësuar që paralelisht me krijimin e bazës së të dhënave për shërbime të veçanta, të krijojmë një qendër tregtare shërbimesh, që do të thotë se njerëzit nuk do kenë nevojë

të shkojnë nga një zyrë në një tjetër, por t'i ketë shërbimet në një qendër të vetme shërbimesh që do të funksionojë online po nevojën e ndërveprimit me sportelistët dhe korrupsionin që e dimë se si ka funksionuar e vazhdon të funksionojë", tha Rama. Për kryeministrin ky rrjet shërbimesh do të shtrihet në gjithë vendin, përfshirë edhe bashkitë. "Komunat e sotme apo bashkitë që do të përfshihen brenda bashkive



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

të mëdha do t'i kthejë në njësi shërbimesh online. Paralelisht po punojmë me Bankën Botërore për të transformuar shërbimin në ato raste kur do të jetë e nevojshme të ketë sportel dhe një komunikim me përfaqësues të institucioneve", -tha Rama.

DENONCIMET
Në fokus të fjalës së tij, kreu i qeverisë vuri edhe komisaratin dixhital, aplikacioni më i ri ku qytetarët denoncojnë shkelje të ndryshme pa dashur të shkojnë fizikisht në stacionet policore. Sipas Ramës, në vetëm pak ditë nga prezantimi, komisarati dixhital është aplikacioni më i shkarkuar sot në telefonat e shqiptarëve. "Qytetarët janë të gatshëm dhe i presin me dëshirë këto transformime dhe mundësinë e aksesit të drejtpërdrejtë në marrëdhënie me institucionet përmes teknologjisë, pavarësisht prapambetjes që

SHËRBIMET
Me lancimin e këtij portali qytetarët nuk do të rrinë më në radhë për të paguar faturat e energjisë, taksat e makinës, apo regjistrimin e biznesit, por nga celulari në vetëm pak minuta.

PORTALI
Aktualisht, shërbimet që ofron ky portal janë 150 por synohet që numri të shkojë në 250 brenda vitit. Ndërsa shërbimet e informimit janë rreth 600, por që gjithashtu synohet shtimi i tyre

PAGESAT

Vangjush Dako: Portali unik, shërbim 60 mijë familjeve durrsake

Kryetari i bashkisë së Durrësit Vangjush Dako i pranishëm në prezantimin e e-Albania, tha se me këtë reform të rëndësishme, qytetarët mund të paguanë dhe taksat vendore, nga shtëpia, dhe ky shërbim do të ofrohet në gjithë qarkun. "Promovoj sot disa shërbime që qytetarët e Durrësit i përfitojnë nëpërmjet këtij portali unik që do të shërbejë 60 mijë familjeve durrsakë, për të paguar online taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit dhe ndriçimit etj. Informatizimi i bashkisë ka sjellë që menaxhimi i bashkisë të jetë më modern. Ne jemi në proces të vazhdueshëm transformimi dhe falë këtij projekti do të japim mundësi qytetarëve që të paguanë faturën në mënyrë elektronike dhe të bëjnë pagesat në bankat e nivelit të dytë" tha kreu i Bashkisë së Durrësit.

SHËRBIMET / SYNOHET QË NUMRITË SHKOJË NË 250 BRENDA VITIT

e-Albania, portë unike e shërbimeve qeveritare

Portali qeveritar e-Albania, është një portë unike në internet, ku qytetarët, bizneset dhe vetë nëpunësit qeveritarë, mund të përfitojnë shërbime elektronike. Dje u prezantuan shërbimet e reja që ofron ky portal, i cili vjen i ridizenjuar plotësisht, më estetik, më i lehtë dhe më praktik. Versioni i ri vjen i shoqëruar edhe me një version të optimizuar për pajisjet mobile, si dhe me aplikacionin mobile për Android dhe IOS. Portali shfrytëzon platformën qeveritare të ndërveprimit në të cilën institucionet lidhen dhe shkëmbejnë informacione me njëri-tjetrin. Portali së bashku me platformën qeveritare të ndërveprimit nëpërmjet të cilës institucionet ndërveprojnë, duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale, janë pjesë e rëndësishme e strategjisë së qeverisë për të ofruar shërbime elektronike, nëpërmjet një pike të vetme kontakti. Hapja e aktivitetit u krye nga drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) Linda Karcanaj, që sqaroi në detaje ndryshimet. Karcanaj tha se me lancimin e këtij portali qytetarët nuk do të rrinë më në radhë për të paguar faturat e energjisë, taksat e makinës, apo regjistrimin e biznesit, por ky proces mund të kryet goftë dhe nga celulari në vetëm pak minuta. Aktualisht shërbimet janë 150 por synohet që numri të shkojë në 250 brenda vitit.

JUXHIN MUSTAFARAJ TIRANË

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani ka vendosur të mos dekretojë ligjin e qeverisë për dhënien me konsencion të rrugës së Arbrit me procedurë të veçantë për kompaninë shtetërore kineze. Vendimi i kreut të shtetit për bllokimin e një projekti kaq të rëndësishëm për të gjithë shqiptarët merr nuanca të forta politike në një kohë kur vetë opozita e mbështeti vijimin e projektit për rrugën, duke dhënë votën e saj pro në Kuvend. Nishani ka pasur në zyrën e tij prej datës 16 prill 2015, ligjin nr.41/2015 për dhënien me konsencion me procedurë të përsheptuar për kompaninë kineze "China State Construction" dhe pa asnjë motiv ka lënë në "harrësë" dekretonin e tij. Mungesa e dekretonit pengon vijimin e punimeve për rrugën e Arbrit, në një kohë që ligji për të jo pa qëllim u propozua të ishte me procedurë të përsheptuar. Në faqen e presidencës, rezultoni të jenë të dekretuar edhe ligji nr.40/2015 dhe ai nr.42/2015 ndërkohë që mungon ligji 41/2015 që i përket kontratës së qeverisë me kompaninë shtetërore kineze për vijimin e punës në rrugën e Arbrit. Opozita në seancën e 16 prillit votoi pro këtij ligji të

Votimi
Kuvendi miratoi në seancën plenare të 16 prillit me 91 vota pro asnjë kundër dhe asnjë abstenim projektligjin për dhënien me konsencion të rrugës së Arbrit për kompaninë shtetërore kineze



Përfitimet
Ndërtimi i rrugës së Arbrit shkurton kohën e udhëtimit drejt Maqedonisë. Gjithashtu nëse tani nga Tirana në Dibër shkohet për 4 orë, pas ndërtimit i njëjti itinerar do kryhet për 1 orë e 30 minuta

shkurtyr që bashkon shqiptarët, Tiranën me Peshkopinë, Dibërën dhe Shkupin. Kostoja është shumë e lartë. Do tu themi shqiptarëve. Mund të kalojë dhe në 1 miliardë, por fizibiliteti është kombëtar dhe unë jam për ta votuar atë. Kjo është kostoja, le të jetë, është rrugë kombëtare ajo, duhet", u shpreh Berisha në seancën e 16 prillit. Ndërkohë që bllokimi për këtë rrugë nga opozita ishte menduar të bëhej në një tjetër institucion. Atë që opozita e legalizoi në parlament, Nishani vendosi ta bllokojë në Presidencë kur për më shumë se një muaj ky ligj ka qëndruar në zyrën e tij. Megjithatë ligji sipas procedurave parlamentare ka kaluar në "heshitje" në mungesë të një dekreti nga Nishani dhe dhe është publikuar në fletoren zyrtare. Do të duhet të kalojnë edhe 15 ditë të tjera që ligji të hyjë në fuqi ndërkohë që nga qeveria ai ishte parashikuar të kalonte me procedurë të përsheptuar në Kuvend duke mos menduar vonesat e pajustificuara që mund të sillte dekreti i tij në presidencë. Rruga e Arbrit do të ketë një gjatësi prej 65 km. Nga viti 2007-2009 u përfunduan 17 km ndërkohë që në proces ndërtimi vijojnë të jenë edhe 16 km të tjera. Tashmë pjesa e mbetur konsiderohet edhe si më e vështira për shkak të tunelit të Qafë Murritit, e cila është marrë përsipër nga kompania kineze "China State Construction".

Nishani "harron" të dekretojë Rrugën e Arbrit

Ligji për vijimin e rrugës kaloi me konsensus në Kuvend, pro tij votoi edhe opozita

qeverisë, megjithëse e dinte që ky investim do të rriste shumë mbështjen ndaj mazhorancës në zonën e Dibërës. Qëndrimi i opozitës ishte i arsyetuar për aq kohë sa vendi për një muaj

do të zhvillojë zgjedhjet vendore dhe kundërshtimi i atij projekti do të përkthehej në kosto elektorale për Partinë Demokratike. Nga foltorja e Parlamentit, ish-kryeministri

Berisha u shpreh se pavarësisht kostove të larta rruga duhej bërë. "Sot Kuvendi voton një nga projektet për të cilat qeveria e PD dhe koalicionëve punoi me përkushtimin më të madh,

ndërtoi më shumë se gjysmën e saj por mbeti pjesa më e vështirë e tunelit të Qafë-Murritit dhe Ura e Vashë. Vlerësoj faktin që i qëndruar kontratës. Rruga e Arbrit është segmenti më i



with funding from
Austrian
Development Cooperation

INVITATION TO BID

Contract: Water Supply and Sanitation Sector Program, Albania, Component 2, Procurement No.:

010/2015/ - Supply and Installation of Laboratory Equipment and Training

GFA Consulting Group, hereinafter referred to as GFA, on behalf of the Ministry of Transport and Infrastructure / General Directorate of Water Supply and Urban Waste Policy (GDWSUWP) and the General Directorate for Water Supply and Sanitation (GDWSS) invites sealed bids from eligible bidders for the Supply and Installation of Laboratory Equipment and Training.

The procurement is based on the Austrian Procurement Act (Bundesvergabeegesetz 2006, Fassung vom 19.03.2013; VBergG 2006; BGBlA 2012) and in particular for "Procurement of Goods".

The supplies are for the use in the laboratories of the water treatment plants in Durres and Kavaje in Albania. The scope of supplies comprises:

- Laboratory Equipment
- Chemicals
- Glassware, Other Consumables

Delivery will be required within six (6) weeks of contract signature.

Bidding for this project is open to all eligible companies.

A complete set of bidding documents may be collected by interested bidders at the office of the GFA Consultant located at Rruga Pjeter Bogdani, Pallati 39 / 1, App. 5 / 3 (5th Floor), 1000 TIRANA, ALBANIA, from Monday, 18 May 2015 onwards.

Upon request of the prospective bidders, bidding documents will be sent electronically; but GFA Consultant will not be responsible for timely and correct delivery of the documents.

Bids must be delivered to the office at the address below on or before Friday, June 06, 2015, 12:00 hours local time. Bids must be prepared in English language. Electronic bids shall not be permitted.

Prospective bidders may obtain further information from, and inspect and collect the bid documents at the office mentioned above, or by email at procurement@wassp-albania.com.

Clarifications may be requested until Friday, May 29, 2015, answers will be submitted to all bidders. Any Bid received by the Consultant Consortium after the deadline prescribed will be returned unopened to the Bidder.

LAJME SHKURT

Blushi në Kumanovë: "Kujtimi i dhimbshëm"



Deputeti Socialist, Ben Blushi është ulur këmbë kryq me banorët e lagjes së Trimave, në Maqedoni. Ngjarja në Kumanovë, sipas Blushit është e frikshme jo vetëm për shqiptarët, por për gjithë Maqedoninë. Sipas tij, ajo që shqiptarët kanë vuajtur është një padrejtësi dhe pabesi. Deputeti socialist, Ben Blushi ka takuar banorët dhe është ndalur në shtëpitë e tyre të rënuara. Pamjet e lagjes së Trimave, deputetit Blushi i kanë kujtuar konfliktet e përgjakshme në Ballkan. "Kujtimi i vetëm që kam... kujtim i dhimbshëm, por i bukur", tha ai duke treguar një gëzhojë.

Rinovimi i eurobondit, zgjedhet "Deutsche Bank" dhe "J.P.Morgan"

Zëvendësministri i Financave, Erion Luçi tha se përzgjedhja e "Deutsche Bank" dhe "J.P.Morgan", si udhëheqëse në rinovimin e eurobondit, rrit garancitë për sukses. Qeveria beson se, përmes rinovimit do të kursejë parë për buxhetin. Sipas Luçit, borxhi, që 5 vjet më parë u mor me interes 7.5 për qind, do të zëvendësohet me një borxh me interesa dukshëm më të ulëta. Madje, nëse situata në tregjet financiare do të mbetet pozitive, qeveria mund marrë më shumë se 300 milionë euro, për të zëvendësuar edhe borxh të brendshëm, përveç eurobondit.



Meta: Nuk ndryshojnë marrëdhëniet Shqipëri-Turqi

Kryetari i Kuvendit Ilir Meta tha dhe se deklaratat e presidentit Erdogan për mybillen e shkollave të ish-aleatit të tij, Fetullah Gulen në vendin tonë, nuk kanë lidhje me marrëdhëniet mes Turqisë dhe Shqipërisë. Në një prononcim për gazetarët nga kryesia e Kuvendit, Meta preku edhe situatën e tensionuar politike në Maqedoni dhe ngjarjen në Kumanovë, ku bëri apel që forcat politike shqiptare në Shkupin zyrtar të bashkëpunojnë. Dalja publike e kryeparlamentarit Meta ishte me rastin e një urimi për takimin e stabilizim asociimit që u zhvillua në Bruksel.



KODHELI



Ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli në prezantimin e kandidatit të majtë për kryetar bashkie në Mirditë, Ndreçë Deda është shprehur se vota për të do të jetë votë për zhvillimin e kësaj zone.

Edi Rama i cilëson kandidatët për sherr të zgjedhurit e PD për të garuar për kryetar bashkie në zgjedhjet lokale të 21 Qershorit. Ndërsa prezantoi kandidatin e koalicionit të majtë për Bashkinë e Mirditës Ndreçë Deda që e cilësoi "njeriun e ndershëm dhe të punës i cili do të vijojë më tej rrugën e transformimeve të mëdha", ai përcolli shembullin e kryebashkiakut në ikje të Tiranës Lulzim Basha si model që s'duhet ndjekur në këto zgjedhje. I shoqëruar nga ministria e Mbrojtjes Mimi Kodheli dhe deputetja e LSI Monika Kryemadhi, kreu i qeverisë ka tekta bëri ironi me punën e Bashës në krye të bashkisë së Tiranës, s'la pa përmendur dhe kandidatët e PD si të papërshtatshëm. "Kush nisët të votojë kandidatin e PD duhet të thotë, ku e kanë këta një model që ta shoh. Më të mirin e tyre kanë këtë të Tiranës, pyesni në Tiranë çfarë ka bërë në 4 vjet? Zero, gjumë me gërhima. Ishte ministër Transporti, për çfarë e mbani mend? 230 milionë euro në drejtim të paditur, dihet ku kanë shkuar po sa pa u kapur po e quajmë të paditur. Kur ishte ministër i Jashtëm i firoi deti me firmën e vet. Si ministër i Brendshëm mos e pyet e mbylli me 4 të vrarë në kurriz. Si kryetar bashkie bëri një gjë: S'bëri asgjë. "Siç hyri doli kastravec", thotë populli. Ky është më i miri se ka edhe më keq", tha Rama. Ndërsa, në anën tjetër qëndrojnë kan-

didatët e koalicionit të majtë që vijnë në garë me projekte konkrete për të ndryshuar vendin. "Era e ndryshimit po fryn në Krëshen. Aleanca jonë që ka në themel partneritetin strategjik mes dy partive PS-LSI, një forcë e madhe udhëheqëse e transformimit, ka një vizion të qartë për qytetet e fshatrat, për nevojat e rrugët që duhet tu çelim për të plotësuar nevojat e tyre e për t'i kthyer vendbanimet në territore ku asgjë nuk është e pamundur. Një palë tjetër nuk ka asnjë haber se çfarë duhet bërë që komunitetet të jetojnë më mirë. Një kandidat që është kryetar komune, pyeteni a ka bërë ndonjë përpjekje në këto 18 muaj të takohet me mua a me ndonjë ministër, të çojë ndonjë projekt, të kërkojë

Rama: PD kandidatë shjerri, Basha hyri dhe doli kastravec

Kryeministri prezanton kandidatin për kryebashkiak në Mirditë Ndreçë Deda: Njeriu i ndershëm e i punës



Rama në Rreshen

ndihmë. Asnjë nuk ka bërë asnjë përcapje për të marrë mbështetjen e qeverisë sepse për ata kjo është e pamundur, nga një anë s'dinë. Kanë bërë projekte pa asnjë lloj haberi të miratuara nga qeveria e shkuar. Tani në këto zgjedhje

që familjet duhet të vendosin se ku duhet çuar vota, ata çfarë propozojnë? Propozojnë vetëm sherr. Kandidat për sherr. Merren me politikën e madhe, me qeverinë, me probleme që s'kanë lidhje me kryetarin e Bashkisë. Ata

duan të kenë në çdo bashki dikë që të mos bëjë asnjë punë", tha kryeministri. Rama tha se brenda 4 viteve çështja e ujit do jetë e zgjidhur, pasi pas zgjedhjeve, me ndarjen e re territoriale do fillojë të vihet në zbatim reforma e qeverisë për

PREZANTIMI

Kryemadhi: Fitorja në Mirditë, e garantuar



Monika Kryemadhi ka qënë dje bashkë me kryeministrin Rama në Mirditë, ku është prezantuar kandidati i ASHE që garon në zgjedhjet vendore të 21 qershorit. "Ne politika duhet ta mbajmë fjalën me ju, fitorja e garantuar e Ndreçë Deda në Mirditë është e garantuar", tha Kryemadhi. Deputetja e LSI ka nënvizuar se kandidati Ndreçë Deda është bashkëpunëtor i saj, ka mbështetjen maksimale të deputetëve të qarkut të Lezhës, të qytetarëve të kësaj Mirditës, ndaj edhe fitorja në këtë bashki është e garantuar.

ujin, ku çdo bashki do të ketë sistemin e vet të ujësjellësit dhe do ketë përgjegjësi kryetarin e bashkisë. Nga ana e tij, kandidati për kryetar bashkie i Mirditës Deda është shprehur se do të jetë vetëm në shërbim të qytetarëve.

NJOFTIM

ZGJEDHJET LOKALE, SOT NË 18:00 NË AIREPORT SONDAZHI I PARË I PIEPOLI

Sot në orën 18:00 në ekranin e A1 Report do të ndiqni sondazhin e zhvilluar nga Instituti Italian Piepoli për zgjedhjet e 21 qershorit. Institutin Italian Piepoli, është i njohur në Itali si qendra më e vjetër dhe profesionale e sondazheve. Në studion e A1 Report do të jenë Carlo Bollino dhe Ilir Babaramo, analistët Aleksander Çipa, Arjon Sulo, Armand Mero dhe Lorenc Vangjeli. Gjithashtu në studion e A1 Report do të jetë Roberto Baldassari, President i Institutit Piepoli.

OFERTË PUNËSIMI

Një kompani mediatike kërkon të punësojë **menaxher marketing**, part-time nëpër rrethe që plotëson kriteret e mëposhtme:

Të ketë arsim të lartë

Të ketë përvojë pune

Të jetë i gatshëm për të punuar në terren

Personat e interesuar të dërgojnë CV-të e tyre në adresën: aurorashkoza84@yahoo.com

LAJME SHKURT

Renditja në fletën e votimit Komisioni Qendror i

Zgjedhjeve (KQZ) ka hedhur dje shortin e renditjes së kandidatëve në fletën e votimit për 10 bashki. Në Tiranë, të parët në listë janë kandidatët e pavarur Gjergj Bojaxhi dhe Sazan Guri, përkatësisht i pari dhe i dyti. Renditja vijon me kandidatin e Partisë Demokratike, Halim Kosova (i treti); Dhimitër Muslia, i mbështetur nga Partia



Kristian-Demokrate; Arben Tafaj dhe i gjashti kandidati i Aleancës për Shqipërinë Evropiane, Erjon Veliaj. Ndërsa, në Durrës, kandidati i ASHE, Vanjush Dako do të mbajë numrin 1, ndërsa kandidatja e opozitës, Grida Duma do të mbajë numrin 2.

Lulzim Basha: Partia Demokratike ul tarifat për studentët



Kreu i PD, Lulzim Basha, gjatë një takimi me të rinjtë e Kukësit premtoi ulje të tarifave studentore për universitetet publike. Papunësia dhe sulmet ndaj qeverisë Rama ishin gjithashtu kryefjalë e takimit të liderit demokrat më të rinjtë e Kukësit. Referuar rastit të dhunës policore në këtë qytet, ku qytetarët po protestonin për energjinë elektrike, Basha theksoi se kjo mazhorancë nuk ka mbajtur asnjë premtim dhe u ofron qytetarëve vetëm dhunë dhe mjerim. Kandidati për kryetar i Bashkisë së Kukësit, Bashkim Shehu tha se nuk mund të pranohet që kryebashkiaku aktual të punojë vetëm për familjen e tij.

Kavajë, Rroshi: Do asfaltojmë e ndriçojmë çdo rrugë

Kandidat i ASHE-së për bashkinë e Kavajës, Elvis Rroshi në takimin me banorët e lagjes nr 5 në Kavajë, ka thënë se në 4 vitet e ardhshme do të bëhet asfaltimi dhe ndriçimi i çdo rrugë të Kavajës, duke përfshirë edhe infrastrukturën. Kryebashkiaku i Kavajës u është përgjigjur edhe akuzave ndaj tij me fjalët se ai jep llogari vetëm përpara qytetarëve të Kavajës. "Sa i përket atij Don Kishotit të Tiranës, Elvis Rroshi nuk bën as trama as metro, Elvis Rroshi bën punën që kanë nevojë qytetarët e Kavajës", tha Rroshi. Elvis Rroshi deklaroi se është 24 orë në shërbim të qytetarëve të Kavajës.



Gjici paralajmëron audit të "investimeve elektorale"

Kandidati i "Aleancës për Shqipërinë Evropiane" për bashkinë Kamëz, Safet Gjici ka paralajmëruar audit të investimeve aktuale në Kamëz, që sipas tij po bëhen për qëllime elektorale. Paralajmërimin, Gjici e dha gjatë një takimi me banorët të zonës së Bathores. Gjici akuzoi kryebashkiakun e djathtë Xhelal Mziu se ka vjedhur fondet duke hedhur pak investime në zone. Gjici është ndalur edhe në Vallas, ku premtoi se në 100 ditët e para, të punës, do të ndërhyhet në problemet më emergjente që kanë të bëjnë me furnizimin me ujë të pijshëm, përmirësimin e rrugorëve e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza.

Veliaj, kontratë me 10 pika me mësues, prindër e nxënës

Kandidat i majtë "ngel" në klasë Bashën. Kosova: Gati më ke për debat me projekte konkrete

Erion Veliaj, kandidati i Bashkisë së Tiranës ka prezantuar një kontratë me 10 pika për mësuesit, prindërit dhe nxënësit për çerdhet, kopshtet dhe shkollat. "Pika e parë e kontratës me prindërit e mësuesit e qytetit të Tiranës, të sigurojmë ngrohjen në kopshtet, çerdhet dhe shkollat brenda vitit të parë. Pika e dytë, të vendosim sinjalistikën rrugore dhe elementët e sigurisë në çdo institucion arsimor e të kujdesit social brenda 100 ditëve të para. Pika e tretë të ndërhyjmë në çerdhe, kopshte e shkolla për rikonstruksion e rehabilitim për terrenet sportive dhe ambientet e jashtme rekreative që duhen çliruar. Pika e katërt, pajisim çerdhet dhe kopshtet me materiale

KONTRATA JONË ME TË RINJTË

- Themelojmë Këshillin e të Rinjve
- Rrisim buxhetin për rininë
- Karta e të Rinjve dhe e Studentit
- Shkollat si Qendra Komunitare
- Nxsisim sipërmarrjet rinore
- Rrisim sigurinë në shkolla
- Ngremë inkubatorin e Biznesit
- Rikthejmë klasat sportive
- 6 Qendra të reja Rinore
- Rikthejmë RINFEST-in

të reja didaktike dhe ndihmëse për zhvillimin e fëmijëve brenda vitit tonë të parë", tha

Veliaj. Ndërkohë që ai tha se si pikë e pestë është ndërhyrja në 10 shkolla qendra komunitare

në vitin e parë. "Pika e gjashtë, 50 shkolla qendra komunitare në total. Pika e shtatë, 10 veta staf për shkollë në ofrimin e shërbimeve të shkollave si qendër komunitare me 100 punësime vitin e parë e 500 brenda mandatit. Pika e tetë, të ndërtojmë 5 çerdhe të reja. Pika e nëntë, 8 kopshte të integruara me çerdhe. Pika e dhjetë, të ndërtojmë 10 shkolla të reja", tha Veliaj. Ku të gjitha pikat do jenë të realizuara brenda mandatit të parë, për të kapur një total prej 100 kopshtesh e 200 shkollash bashkinë e re. "Në vitin elektorale 2013, Basha ka realizuar vetëm 26% të investimeve të programuara për arsimin parauniversitar të edukimit. Pra as notën 4, por 26% nga 100% që do ishte nota 10, merr notën 2.6", tha Veliaj.



Erjon Veliaj me të rinjtë



Halim Kosova në takim

Ndërsa kandidati i opozitës Halim Kosova pranoi sfidën e Veliajt për një debat publik, me projekte konkrete. "Për të debatuar për një projekt në të mirë të qytetarëve më ka në fushë të betejës e s' dal pa fitore", tha Kosova, ndërsa ka

premtuar se do realizojë menjëherë sapo të fitojë më 21 qershor, projektin e Bashës për stacionin multimodal, duke nënvizuar se kurrë në krye të bashkisë nuk do të lejohet që përplasjet politike të vuajnë qytetarët.

Raiffeisen BANK, requires to employ qualified candidates in the following position:

Corporate & SE Bad Loans Execution Officer – Legal Department



Overall job definition:

The Execution Officer follows the process of execution of bad loans to be sent to court and bailiff according to bank procedures.

Main responsibilities :

- Regularly monitors the list of past due borrowers, as per Problem Loan Committee (PLC) decisions;
- Prepares the requests to court and follows the procedure for the release of execution orders;
- Follows all the administrative procedures for payment of taxes in order to enable the start of the execution procedure in Bailiff;
- Prepares the file to be submitted to the Bailiff's Office and closely follows the execution procedure with bailiff through all execution phases;
- Keeps and updates reports on execution cases;
- Informs Credit Control & EWS Department and Account Managers on any legal proceeding involving bank's clients;
- Informs Credit Control & EWS Department on changes of legal regulations that can significantly affect client performance in the future;
- Informs Late Workout officer on client status in legal proceedings handled by Legal officer;
- Reports to Head of Legal Department and PLC;
- Performs other tasks as required by the supervisor.

Competencies / Skills :

- Bachelor degree in Law;
- At least three years of experience in execution of non-performing loans, bailiff procedures and enforcement; experience with court cases related to execution preferred;
- Good organizational skills, persistence and ability to handle difficult situations;
- Good command of English language, written and spoken, good report-writing skills;
- Good communication and orientation skills; available to travel for business purposes;
- Capacity to strictly comply with work rules and procedures;
- Very good team player;
- Very good knowledge of Microsoft Office programs.

The interested candidates must present to the **Human Resources and Training Division**, within **25 May, 2015**, the following documents:


- Cover Letter
- Detailed CV

The documents must be sent to the following address:

E-mail: humanresource@raiffeisen.al

Only the candidates selected for the interview shall be informed. For further detail, please address to the Human Resources & Training Division in Raiffeisen BANK.

LAJME SHKURT



Kandidatja Grida Duma, takim me gratë e Durrësit

Grida Duma, kandidatja e opozitës për bashkinë e Durrësit bashkëbisedoi dje me gra dhe vajza të qytetit. Duma tha se nuk është bërë sa duhet për gratë ndërsa shtoi se modelin e gruas qytetare e të fisme do ta çojë në Bashkinë e Durrësit. Kandidatja e djathtë u shpreh se bashkia e Durrësit do qeveriset nga kapacitet e mëdha që ka qyteti për të ndaluar largimin e tyre drejt Tiranës. Duma tha se durrsakët i kanë dhënë shumë kryeqytetit dhe do të krijohen mundësi që ata të jenë pjesë e bashkëqeverisjes së qytetit të tyre.

Vangjush Dako: Gati rruga që lidh Sukthinë me bregdetin

Rikonstruksioni i rrugës që përshkon zonën e Sukthit dhe lidh autostradën me bregdetin, do fillojë vitin e ardhshëm. Ky është premtimi që ka bërë kandidati i majtë për bashkinë e Durrësit, Vangjush Dako gjatë një takimi që zhvilloi dje me banorët e Sukthit. Dako premtoi gjithashtu edhe hapjen e qendrave sociale për njerëzit në nevojë, ndërsa shtoi se nuk do mungojnë investimet në bujqësi. Ai deklaroi se në sajë të një investimi që do të kryhet nga ndërmarrja e ujësjellësit, brenda 14 muajve do të zfishohet sasia e ujit të pijshëm që do të furnizojë Durrësin, duke zgjidhur këtë problem në Sukth.

Bojaxhi: Të ndalet masakra mjedisore

Kandidati i pavarur për Bashkinë e Tiranës, Gjergji Bojaxhi ka dalë dje në një deklaratë për mediat, ku është shprehur se ndeshja mes dy kandidatëve të dy forcave politike për bashkinë është një teatër. Teksa denoncoi kthimin e parkut në një kantier ndërtimi pa njoftuar më parë qytetarët për këtë vendim, Bojaxhi tha se gllabërimi i parkut është një nga të këqijat më të mëdha që po i bëhen këtyrë vendi. Ai bëri thirrje që të ndalet 'kjo masaker' me anë të votës së 21 qershorit. "Më 21 qershor ne duhet të votojmë kundër padrejtësive dhe grabitjes që i është bërë së ardhmes sonë", u shpreh ai.



2133 LEJË

ELTON QYNO TIRANË

Nga 21 maj deri 10 ditë pas zgjedhjeve lokale të 21 qershorit, të gjithë të burgosurit nuk do të kenë mundësi të dalin me leje shpërblyese. Ky vendim u bë publik nga ministri i Drejtësisë Nasip Naço i cili u shpreh se ky vendim është marrë për të mos patur asnjë pakt në kurriz të sigurisë publike. Referuar kohës kur Ministria e Drejtësisë drejtohet nga Partia Demokratike, Naço u shpreh se shifrat e 2013-ës ku janë dhënë 2133 leje shpërblyese dhe 512 leje të veçanta, tregojnë se të burgosurit janë përdorur për fushatë elektorale. Aktualisht urdhëri për ndalimin e lejeve të të burgosurve u është shpërndarë të gjitha burgjeve, ndërsa pritet që me komisionin qëndror të zgjedhjeve të krijohen të gjitha kushtet për votimin e të burgosurve brenda ambienteve të burgut ku ata vuajnë dënimin.

BASHKËPUNIMI ME KQZ

Ndërkohë, sipas Naços me qëllim parapërgatitjen e infrastrukturës së nevojshme zgjedhore, është komunikuar dhe është bashkëpunuar dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ku është konkluduar në lidhje me: Hartimin, sipas institucioneve të listave të të dënuarve e të paraburgosurve që janë votues në njësitë vendore ku ndodhet IEV/Penale, Përcjelljen brenda afatit ligjor të të dhënave per-



Naço u shpreh se shifrat e 2013-ës ku janë dhënë 2133 leje shpërblyese dhe 512 leje të veçanta, tregojnë se të burgosurit janë përdorur për fushatë elektorale.

sonale në Zyrat Rajonale të Gjendjes Civile, Dërgimin e kopjeve të listave të zgjedhësve në IEVP dhe DPB, si dhe mbarevajtjen në tërësi të procesit zgjedhor. Nga ky proces bashkëpunues me institucionet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe në vlerësim të faktit që Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe IEVP hyjnë në listën e institucioneve të rëndësishme të veçantë, votimi për shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës do të bëhet në institucion, përfshirë edhe ata të burgosur që nuk kanë vendbanimin në zonën zgjedhore ku ndodhet IEV/Penale përkatëse.

POLICËT NË FUSHATË

Nëpërmjet masave të marra

Naço: Asnjë leje për të dënuarit gjatë zgjedhjeve

Ministri pezullon lejet për fushatën elektorale policët e burgjeve të mos angazhohet në zgjedhje



Ministri i Drejtësisë Nasip Naço

deri më tani mund të themi me siguri se po garantojmë zbatimin e parimit universal të së drejtës së individit për të votuar, pavarësisht kufizimit të lirisë fizike. Një masë tjetër e marrë deri më tani është urdhëri i të gjitha Institucion-

eve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale që në funksion të garantimit të rendit dhe sigurisë, si dhe në kryerjen e detyrave funksionale të marrin masat e nevojshme për: Ndalimin e vënies në përdorim të burimeve njerë-

zore, financiare dhe logjistike të sistemit penitenciar për zgjedhjet vendore të datës 21 qershor 2015, në mbështetje të individëve kandidatë apo subjekteve zgjedhore. Zbatimin e gjithë urdhërimeve ligjore dhe nën-

MINISTRI

Asnjë tolerancë ndaj atyre që shkelin rregullat




Ministri i Drejtësisë i ka kërkuar drejtuesve të burgjeve që të zbatojnë me përpikmëri urdhërimet e Kodit Zgjedhor, me qëllim ndalimin e vënies në dispozicion të materialeve të ndryshme zgjedhore, si dhe të ndalohet përfshirja e stafit për fushatë zgjedhore brenda IEVP-ve. "Si Ministër i Drejtësisë, sot angazhohem publikisht se të gjitha masat e mësipërme do të respektohen rigorozisht dhe nuk do të ketë asnjë tolerancë ndaj askujt që do të gjejë guxim për të mos ndjekur qoftë edhe një detaj nga ky plan masash"-ka pohuar Naço.

ligjore në fuqi, në mënyrë që punonjësit me uniformë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve por edhe stafi civil të mos angazhohet në fushatë zgjedhore për përfaqësuesit e subjekteve politike të zgjedhjeve të pushtetit vendor.

LAJME SHKURT

Rama kërkon dënim penal, Paloka: Je i lidhur me krimin

Në Gjykatën e Lartë është zhvilluar dje seanca e radhës mes kreut të qeverisë, Edi Rama dhe të paditurit prej tij për shpifje, kreut të grupit parlamentar të PD-së, Edi Paloka. Mbrojtja e Ramës ka kërkuar dënim penal ndaj Palokës, i cili akuzoi shefin e qeverisë për lidhje me bandat e krimin. Ndërkaj, avokatët e deputetit të PD-së, kanë kërkuar pushimin e çështjes pasi sipas tyre, nuk ka vepër penale në deklaratat e klientit të tyre. Ndërsa Gjykata e Lartë pritet të nxjerrë konkluzionet më 29 maj, Paloka ka deklaruar se lidhjet e Ramës me krimin janë publike.



ILDKPKI kallëzon 5 kryekomunarë, mes tyre Genci Drita

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar për ndjekje penale 20 subjekte për mosdeklarimin e pasurisë. Mes tyre janë 5 kryetarë komunash, 7 inspektorë të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve, një kancelar gjykate, 2 inspektorë të doganave, një drejtor i ministrisë së transportit dhe infrastrukturës. Mes të kallëzuarve është dhe ish kryetari i komunës Berzhit Genci Drita, i cili aktualisht ndodhet nën hetim për akuzën e korrupsionit gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e tij si funksionar në krye të saj.

Rrëshen, aksidentohet efektiv i burgut të Kuksit

Një efektiv policie, 60 vjeçar, është plagosur dje në mbrëmje në Rrëshen. Sipas burimeve prane policisë së Rrëshenit, 60 vjeçari, Fran Brozi, punonjës i burgut të Kukësit është aksidentuar nga Arjol Perleka, i cili drejtonte mjetin tip 'Benz' me targa AA6361V. Fill pas ngjarjes, autori është larguar me shpejtësi, ndërsa braktisi



mjetin në fshatin Ndërfushas, duke mos i dhënë ndihmën e parë të plagosurit. Sakaq, efektiv i policisë u dërguar me urgjencë drejt spitalit të Rrëshenit, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Forcat policore nisën hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes.


Greqi, kapet shqiptari me 25 kg kanabis sativa



Një shqiptar u kap në shtetin fqinj të Greqisë më 25 kilogram lëndë narkotike kanabis sativa. 35-vjeçari u kap paraditen e djeshme në Arta pasi transportonte në makinë drogën, ndërsa policia kishte marrë më herët informacione në rrugë operative. Sipas mediave greke, shqiptari do ta shiste drogën në Greqi. Lënda narkotike e fshehur në pjesën e poshtme të makinës u zbulua me ndihmën e qenit të policisë. Përveç lëndës narkotike, policia greke sekuestroi edhe dy celularë si dhe një shumë parash prej 1100 Euro.

Zhvillohet konferenca për mbrojtjen e dëshmitarëve

Është zhvilluar dje në Tiranë konferenca "Rrjeti ballkanik në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunorëve të drejtësisë". Konferenca e organizuar nga Policia e Shtetit me mbështetjen e "EINPRO", do të vazhdojë edhe sot dhe ka synim mbrojtjen e dëshmitarëve e bashkëpunorëve të drejtësisë. I pranishëm në takim ishte edhe zv/ministri i Brendshëm Ilir Mustafaraj, i cili vlerësoi projektin për mbështetjen disa vjeçare. Në konferencë marrin pjesë: Serbia, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia dhe Bosnjë - Hercegovina.



Kalonin ilegalisht qytetarët jashtë kufirit, 2 në pranga

Dy persona janë vënë në pranga dje nga policia e Beratit, pasi akuzohen për dhënie ndihmë në kalimin e paligjishëm të kufirit. Albert Kanani, 35 vjeç, dhe Sokol Berisha, 43 vjeç, nga Kuçova, dyshohet se rekrutimin persona me precedentë kriminale dhe i ndihmonin të kalimin në mënyrë të paligjshme jashtë kufirit. Personat kaloheshin përmes pikës së kalimit kufitar të Hanit të Hotit, përkundrajt shumëve 1000-1500 euro për person. Por në sajë të operacionit të koduar "Azilanti", uniformat e policisë kanë bërë të mundur arrestimin e dy të rinjve.

Samiti Rajonal nis punimet kundër terrorizmit

Ministri Tahiri: Askush nuk është imun ndaj terrorizmit, duhet të ndalojmë rrezikun

TAHIRI



"Shqipëria është një vend model për bashkëjetesën fetare. Megjithatë Terrorizmi mbetet një nga shqetësimet më kryesore pasi Ballkani është një nga qendrat ku eksportohen më së shumti terroristët"

SEWAL



"Duhet të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për të ndaluar rekrutimet. Të parandalojmë që fëmijët tanë të bëhen terroristë, si dhe duhet të riafirmojmë vlerat tona kyçe"



Ministeriali rajonal në luftën kundër terrorizmit

XHENSILA KODRA
TIRANE

Është mbledhur dje në Tiranë Ministeriali rajonal kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë takim, Ministri i Punëve të Brendshme Saimir Tahiri dhe nënsekretarja për Sigurinë Civile, Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, Sarah Sewal dolën në një konferencë të përbashkët pas mbylljes së ditës së parë të Ministerialit rajonal në luftën kundër terrorizmit. Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri kërkoi një bashkërendim e bashkëveprim mes shoqërisë civile, komuniteteve vendore dhe fetare me strukturat shtetërore për të parandaluar përhapjen e ekstremizmit, që sipas tij, është kërcënim i përhershëm. "Askush nuk është imun nga rreziku i ekstremizmit. Shqipëria duket sikur nuk ka probleme me ekstremizmin e dhunshëm dhe duket se rajoni sot vetëm eksporton luftat të huaj, por premisat që ekstremizmi të kthehet në problem në shtëpinë tonë janë aty", deklaroi Tahiri. Ndërsa më tej, ai theksoi se asnjë vend nuk është i parrezikuar nga terrorizmi dhe se komunitetet fetare kanë një rol kyç për edukimin, duke apeluar edhe për një përfshirje më të madhe të qytetarëve. "Komunitetet fetare kanë një rol kyç për edukimin. Asnjë vend nuk është i parrezikuar.

Samiti vazhdon edhe nesër (sot) duke përfshirë të gjitha qasjet e një fenomeni që nuk mund në sistemin tonë të trajtohet vetëm me instrumente represivë, por duhet një qasje 360 gradë, ku shoqëria të përfshihet më shumë, ku zëri i komuniteteve fetare, i individit, i mediave të bashkohet me shtetin. Kjo është sfida jonë, që meriton vëmendjen

maksimale, sepse askush nuk është imun nga rreziku i terrorizmit". Ndërsa, më tej Tahiri vuri në dukje se parvarësisht faktit se Shqipëria nuk ka probleme në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm, premisat ekzistojnë dhe duhet ndaluar ky fenomen. Gjithashtu, Tahiri u ndal sërisht të kërkesa e Erdogan, duke theksuar se qeveria

shqiptare e ka bërë të qartë se çdo politizim i terrorizmit është po aq i keq sa terrorizmi. Ndërsa Zv/Sekretarja për Sigurinë Civile, Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, Sarah Sewal, kërkoi më shumë bashkëpunim në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në këtë takim ajo tha se "Ekstremizmi i

dhunshëm është një çështje globale. Të bashkojmë forcat për një dialog fetar. Nevojiten strategji për të arritur qëllimin. Terroristët nuk i njohin kufijtë. Të bashkëpunojmë të gjithë së bashku për të ndaluar rekrutimet. Të parandalojmë që fëmijët tanë të bëhen terroristë. Duhet të riafirmojmë vlerat tona kyçe". Më tej, Ministri Tahiri e vuri theksin tek bashkëpunimi, reformimi i institucioneve, tek standardet e funksionimit të drejtësisë dhe tek lufta ndaj korrupsionit. "Falënderojmë SHBA për ndihmën thelbësore që i ka dhënë Shqipërisë në përgatitjen për tu përballur me këto sfida, ashtu siç doja të falënderoja edhe për samitin që u organizua në Uashington, që shënoi hapat dhe objektivat primarë të axhendës tonë të përbashkët në luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm. E sigurisht bashkëpunimi dhe partneriteti strategjik me SHBA-të kanë dhënë frytet e veta dhe është nxitja më e mirë për të ecur përpara në këtë drejtim", tha në fjalën e tij Tahiri.

LAJME SHKURT

Shkodër, vidhen dokumente nga zyra e Partisë Demokratike




Shënohet incidenti i parë elektoral në qytetin e Shkodrës. Zyra numër 5 e PD në zonën industriale të qytetit verior është vjedhur gjatë orëve të natës. Persona ende të pidentifikuar kanë arritur të futen brenda nga pjesa e pasme dhe të vjedhin një sërë dokumentesh të rëndësishme zgjedhore. Po ashtu ata kanë marrë edhe kompjuterin që kjo forcë politike kishte në zyrë. Sipas drejtuesve të partisë demokratike në Shkodër, ky incident ka prapavijë politike. Policia ka nisur punën për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.

Lezhë, aksidentohet makina përfundon në kanal, plagosen 2

Dy persona mbetën të plagosur, njëri prej të cilëve në gjendje të rëndë, pasi mjeti me të cilin udhëtonin doli nga rruga dhe përfundoi në një kanal. Aksidenti ndodhi në rrugën që lidh burgun e Shënkollit me superstradën Lezhë-Laç, ndërsa të plagosurit janë Sander Mema 59-vjeç dhe Lazer Peraj 57-vjeç. Ata kanë qenë duke udhëtuar në drejtim të burgut të Shënkollit. Dy të plagosurit janë dërguar menjëherë në spitalin rajonal të Lezhës. Nga hetimet e para dyshohet se drejtuesi i mjetit ka qenë i dehur, dhe ka humbur kontrollin duke përfunduar në kanal.

Fier, konflikte mes tregtarëve dhe tatimeve për mungesën e faturave

Dhjetëra tregtarë të shumicës dhe pakicës në qytetin e Fierit kanë kundërshtuar kontrollin e policisë të tatimore për shoqërim të mallit me faturë tatimore. Ata kanë pohuar se furnizohen në treg të lirë dhe nuk marrin fatura për të paguar TVSH-në. Tregtarët thonë se policia tatimore duhet ta kërkojë faturën tek tregtarët e shumicës në Tiranë, ku ata furnizohen me mall. Mbi 20 tregtarë mbyllën dyqanet si një mënyrë për të mos lënë punonjësit e policisë tatimore që t'u sekuestrojnë mallin. Mësohet se tatimet kanë mbyllur rreth 20 dyqane të tregëtimit me shumicë dhe pakicë.



Qëlluan mbi patrullën e policisë, pranga dy autorëve

Policia e Tiranës ka arrestuar Eduart Kaçolli 21 vjeç, pasi dje qëlloi me pistoletë patrullën e policisë. Ngjarja ka ndodhur në rrugën "Him Kolli", ku 21 vjeçari ka qënë i shoqëruar me Ndue Ndue 19 vjeç nga Puka, i cili fillimisht arriti të largohet me një motor, por pak orë më pas u kap nga policia. Sipas burimeve të policisë, bëhet me dije, se Ndue është person me precedent të mëparshëm penal, pasi në 8 Maj të këtij viti ka vjedhur me dhunë shtetasin R.M, ndërsa në Korrik të 2011 së bashku me Eduart Kaçollin kanë vjedhur një motor të tipit "Jamaha" shtetasit me iniciale D.V.

Shkodër, vdes 52-vjeçarja, e përplasi makina

Një aksident me pasojë vdekjen ka ndodhur dje në segmentin rrugor Kopluk - Stërbeç. Një makinë ka përplasur për vdekje një këmbësore, e cila ka ndërruar jetë menjëherë për shkak të goditjes që kishte pësuar. Mësohet se viktima është 52-vjeçarja me iniciale P.L, e cila është dërguar në morgun e qytetit të Shkodrës. Policia ka shoqëruar në komisarjat drejtuesin e makinës që shkaktoi aksidentin me pasojë vdekje. Pritet që uniformat blu të qytetit verior të sqarojnë rrethanat e ngjarjes ku humbi jetën 52-vjeçarja.



Sarandë, tenton të vetëmbytet, e shpëton një kalimtar

Një 50-vjeçare ka tentuar të vetëmbytet në det, por përplekja e saj ka mbetur vetëm në tentativë, ndërsa është shpëtuar falë ndërhyrjes së një të riu që është gjendur aty pranë. Ngjarja ndodhi ditën e djeshme në qytetin bregdetar të Sarandës. Mësohet se Dhurata Mullai nga Qafë-Gjasha ishte hedhur në det, në aksin Turizëm-Kanali i Çukës. Sapo ka parë skenën, i riu Erjon Quku është hedhur në det dhe ka shpëtuar një mbyjtja gruan 50-vjeçare. Ndërkohë, nuk dihen ende shkaqet që kanë çuar 50-vjeçaren që ti jepte fund jetës.

ELTON QYNO TIRANE

Shtatë anëtarë të një grupi që trafikimin klandestinë nga Shqipëria në drejtim të SHBA, kanë përdorur një linjë të gjatë udhëtimi, për të kaluar njerëzit në tokën e premtuar. Nga hetimet që ka zhvilluar prokuroria e Krimeve të Rënda ka zbuluar se 7 shqiptarët e marrë tashmë të pandehur kanë qënë pjesë e një grupi ndërkombëtar, ku klandestinët transportoheshin nga Shqipëria në drejtim të Maqedonisë, ku prej këtej hynin në Bullgari dhe më pas udhëtonin në drejtim të Spanjës dhe pastaj në vendet e Amerikës Qendrore, Nikaragua, Honduras, Guatemala, Meksike dhe më pas në USA. Pjesë e këtij grupi shumë të gjerë ishin dhe 7 personat e arrestuar në Shqipëri si, Enver Karaj, Fatmir Bakalli, Nertil Previzi, Fatos Fasko, Durim Koxha, Nikoll Kolaj dhe Fatmir Flaga. Ndërkohë të arrestuar ka pasur dhe në Maqedoni dhe Bullgari, pasi hetimet kanë zbuluar se kanë qënë pjesë të këtij rrjeti. Këta shtetas akuzohen se, nëpërmjet pagesa që arrijn në shumat 20 mijë-25 mijë dollarë, kanë trafikuar një numër të konsiderueshëm shtetasish shqiptarë në drejtim të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga informacioni i përfutur gjatë hetimit, rezultoi se vetëm gjatë vitit 2013, kanë hyrë në mënyrë klandestine në territorin e SHBA nëpërmjet kufirit me Meksikën rreth 478 shtetas shqiptarë.

NË NJË MUAJ 17 RASTE Sipas informacionit të ar-

Nga Greqia Në datë 03.03.2014, ky grup i strukturuar kriminal ka marrë përsipër një tjetër grup personash për t'i dërguar drejt SHBA, por fillimisht nëpërmjet kufirit tokësor me Greqinë



Pritja Të tre këta të pandehur gjejnë persona që kanë dëshirë për tu larguar dhe realizojnë nisjen për në Maqedoni ku atje personat priten nga i pandehuri Nertil Previzi.

dhe rënien dakord për pagesën që do bënin. Nga të dhënat e hetimit sipas akteve të ndodhura në dosje rezultoi se më datë 06.05.2014, i pandehuri Fatmir Bakalli krijoi kontakte me persona të ndryshëm për të realizuar dërgimin e shtetasve shqiptarë për në SHBA. Vepërimet e tij, ky shtetas i koordinoi me të pandehurin Nertil Previzi (shtetas shqiptar nga Maqedonia/Struga) i cili ka patur hyrje dhe dalje të shpeshta nga territori i shtetit shqiptar. Ky i pandehur është me banim në Maqedoni dhe ka krijuar lidhje me të pandehurit Fatmir Bakalli, Enver Karaj dhe Fatos Fasko. Të tre këta të pandehur gjejnë persona që kanë dëshirë për tu larguar dhe realizojnë nisjen për në Maqedoni ku atje personat priten nga i pandehuri Nertil Previzi apo bashkëpunëtorë të tij.

NISJA E GRUPEVE

Në datë 28.02.2014, i pandehuri Previzi është takuar me shtetasit Fatmir, Enver dhe Fatos në një lokal në Tiranë, nga ku ka marrë shumën prej 50 mijë dollarëve, si pagesë për kalimin e 3 shtetasve shqiptarë nga Shqipëria për në SHBA. Ditën që shtetasit Previzi ka marrë këtë shumë, 3 shtetasit që kishin nisur rrugën drejt SHBA, gjendeshin në Honduras. Po kështu më datë 25.02.2014, i pandehuri Nertil Previzi kishte dalë garant për të dërguar në SHBA 4 shtetas të tjerë (G.J.V, A.N, F.SH, dhe M.Z.L), për të cilët nga verifikimi rezultoi se kishin datë ato ditë nga territori i Shqipërisë. Sipas hetimit, rezultoi se ky grup funksiononte nëpërmjet skemës që, sapo mbërrin njëri grup personash në SHBA, nësin grupin tjetër.

Në një muaj 17 shtetas klandestinë drejt SHBA

Hetimet e akuzës, dërgohen në gjykatë 7 të pandehur Linja nga Shqipëria në Nikaragua, Honduras dhe në USA

hur nga autoritetet amerikane, në lidhje me identifikimin e rastit, rezultoi të jone evidencuar si raste të përsëritura kalimi i kufirit nëpërmjet Meksikës në drejtim të SHBA-së të shtetasve shqiptarë. Në këtë mënyrë janë evidencuar si raste 17 të tilla në muajin Qershor të vitit 2013, dhe për gjithë vitin 2013 është arritur numri prej 478 shtetasve shqiptarë. Të pandehurit Enver Karaj, Fatmir Bakalli, Nertil Previzi, Fatos Fasko kanë krijuar si rezultat i lidhjeve të tyre një



formë të ngushtë bashkëpunimi dhe me persona të tjerë, në drejtim të nisjes së shtetasve të ndryshëm me destinacion SHBA-në. Në këtë vepërimtari ka dhe bashkëpunëtorë të tjerë në rolë të ndara sic është i pandehuri Fatmir Flaga. Disa nga të pandehurit në bashkëpunimin e tyre kanë patur rolin e gjetjes se personave të inetersuar për tu larguar në drejtim të SHBA-së, vënies së kontaktit me ta, përcaktimin e mënyrës së lëvizjes dhe marrjes përsipër të udhëtimit si

LAJME SHKURT

Vrau 3 vajzat e saj, do të qëndrojë 10 vite në psikiatri



Shpallet e pafajshme nëna shqiptare e cila në mars të 2014-ës vrau tre vajzat e saj, pasi sipas Gjykatës se Leccos Edlira Copa nuk ishte e aftë mendërisht natën e krimit. Duke u bazuar në raportin e psikiatrit mjekoligjor, autorja e vrasjes së trefishtë nuk mund të konsiderohet përgjegjëse për krimin në fjalë. Për këtë arsye, Gjykata ka vendosur që 38-vjeçarja të qëndrojë për 10 vite e mbyllur në një institucion psikiatrie të gjykatës. Më 9 mars 2014, Edlira Copa vrau me thikë 3 vajzat e saj në shtëpinë e tyre në Lecco të Italisë.

Librazhd, vdes 30-vjeçarja, e godet rrufeja teksa ndodhej në banesë

Përveç dëmeve në të mbjella nga rreshjet e dendura të shiut e breshërit ditën e djeshme, situata ka marrë përmasa më serioze pasi një grua që është goditur nga rrufeja ka humbur jetën. Ngjarja e rëndë ka ndodhur pasditen e djeshme në fshatin Pishkash të Librazhdit, ku si pasojë e shkakimit të rrufesë ka gjetur vdekjen e menjëhershme Liri Skura, 30 vjeç. Viktima ka qënë në banesë në momentet që është goditur nga rrufeja. Mësohet se 30-vjeçarja ka qënë në banesë së bashku me dy fëmijët e saj të mitur.

Shtyhet gjyqi ndaj imamëve, gjykata largon mbështetësit e tyre

Është shtyrë sërish dje gjyqi ndaj imamëve pasi të pandehurit janë larguar nga seanca për shkak se kanë kërkuar që në seancë të ishin të pranishëm edhe familjarët e tyre. Në seancë ka qëndruar vetëm imami i vetëshpallur Genci Balla ndërsa të tjerët janë larguar.



Të pandehurit kanë deklaruar edhe njëherë se nuk i njohin ligjet, por vetëm Allahun. Me herët trupi gjykoes vendosi të nxjerrë nga salla e gjykitimit të afërmit dhe familjarët e imamëve pasi ata sërish kishin veshur bluzë me mbishkrimin "Jam krenar që jam musliman".




Ahmetaj kontrollon karburantet, asnjë tolerim në treg

Aksi rrugor Tiranë - Elbasan ka qënë ndalesa e vetë ministrit të Ekonomisë Arben Ahmetaj, i cili ka zbritur në terren për të kontrolluar tregtarët që bëjnë evazion në shitjen e karburanteve dhe ata të cilët mashtrojnë me cilësinë dhe sasinë. Ahmetaj ka theksuar se qeveria është e vendosur që të mos tolerojë askënd i cili vjedh buxhetin e shtetit dhe qytetarët. Plani parashikon inspektimin e çdo pike karburanti dhe aty ku gjenden në shkelje do të ketë penalizim deri në mbyllje dhe arrestim të administratorëve të karburanteve që nuk kanë kasa fiskale.

Konflikti me tragjet, pasagjerët 6 orë të bllokuar

Rreth 200 pasagjerë që udhëtonin nga Italia drejt portit të Vlorës kanë qëndruar thuajse 6 orë të bllokuar. Shkak janë bërë mosmarrëveshjet mes shoqërisë së udhëtimeve dhe autoriteteve portuale. Kapiteneria ka sqaruar se sipas grafikut kompania Red Star duhet të prekte kalatën e portit për përpunim në orën 15.00. Trageti ka mundur të ankorohet rreth orës 11.00 ndërsa në bord ka pasur gra dhe fëmijë që kanë shfaqur probleme shëndetësore. Mosrespektimi i orarit për ankorim nga kompanitë ka sjellë një sërë problemesh duke bllokuar punimet 4 herë brenda 10 ditëve.



Belsh, dëme nga rreshjet, mblidhet Shtabi i Emergjencave

Rreshjet e pasdites së djeshme kanë qënë me intensitet të lartë në zonën e Dumresë. Shiu dhe breshëri kanë përmbytur qendrën e Belshit ku uji ka pushtuar lagjet dhe banesat. Shqetësuesë mbeten dëmet që janë shkaktuar në bujqësi nga intensiteti i lartë i reshjeve. Rreshjet kanë përfshirë disa zona në Qarkun e Elbasanit dhe për këtë arsye është mblodhur shtabi i emergjencave në Bashkinë e Belshit. Nga të dhënat paraprake mësohet se reshjet e breshërit të cilat më pas janë shoqëruar me reshje të dendura shiu kanë shkaktuar një sërë dëmsh në tokat e mbjella.

Matura, ç'do të përmbajë provimi i gjuhës së huaj

Për të qënë kalues duhen 10 pikë, nga 50 që ka testi. Do të ketë bllokues për valët e telefonit

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

Pas tri ditësh do të zhvillohet provimi i parë i maturës shtetërore, ai i gjuhës së huaj. Provimi do të nisë në orën 10:00 dhe do të përfundojë në orën 12:30. Edhe këtë vit Ministria e Arsimit do të përdorë bllokuesit e valëve në mënyrë që asnjë kandidat të mos ketë mundësi për të kopjuar. Nga ana tjetër Agjencia Kombëtare e Provimeve u kujton maturantëve rregullat që mund të përjashtojnë nga provimi. "Maturanti përjashtohet nga provimi kur ndryshon vendin që i është caktuar, kopjon, bën komente për përmbajtjen e testit, mban telefon ose mjete të tjera të komunikimit. Po kështu përjashtime ka edhe kur maturanti refuzon kontrollin nga administratorët në momentin e hyrjes në provim, përdor lapsa apo më shumë se një ngjyrë në provimin e testit, kur dëmton testin apo barkodin", - thuhet në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit. Testi i gjuhës së huaj do të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje janë

TESTI



Testi i gjuhës së huaj do të përmbajë 25 pyetje, nga të cilat 13 pyetje janë me alternativa, që vlerësohen me 1 pikë secila dhe 12 pyetje janë me zhvillim, që vlerësohen me 37 pikë



me alternativa, që vlerësohen me 1 pikë secila dhe 12 pyetje janë me zhvillim, që vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet me 50 pikë dhe për të qënë kalues duhet të grumbullohen 10 pikë. Në ditën e

provimit, maturantëve nuk do tu lejohet asnjë shënim dhe administratori ka të drejtë të marrë masë "përjashtim nga provimi", kur vëren se po kopjohet dhe komunikohet me kandidatët e tjerë.

TESTI I ANGLISHTES

Agjencia Kombëtare e Provimeve ka publikuar modelin për të cilin do të testohen të gjithë maturantët në provimin e anglishtes. "The descriptors are as follows: - Can understand the main points of clear standard input on familiar matters regularly encountered in work, school, leisure, etc. - Can deal with most situations likely to arise whilst travelling in an area where the language is spoken. - Can produce simple connected text on topics, which are familiar, or of personal interest. - Can describe experiences and events, dreams, hopes & ambitions and briefly give reasons and explanations for opinions and plans", - thuhet në modelin e testit të AKP-s.

"MASAKRA"

Pallati tek diga, mbetjet hidhen në Liqenin e Thatë



Pas vendimit për ndërtimin e një pallati në digën e liqenit, punime të cilat vazhdojnë edhe sot, në redaksinë e Shqiptarja.com është raportuar hedhja e dherave që dalin nga gërryerja e trullit të digës në Liqenin e Thatë. Fotot tregojnë se të gjitha dherat që dalin hidhen tek Liqeni i Thatë për të mbushur këtë të fundit. Kjo masakër mjedisore është e përditshme dhe nga askush nuk është marrë asnjë masë për ta parandaluar. Asnjë institucion apo shoqatë që mbrojnë mjedisin nuk ka reaguar.

Teuta
Buding Vanilje
Karamel
Çokollatë
aleshtrydhe
Një Mbretëreshë për mikeshë...

Lagja 15, Rruga "Aleksandër Goga", Durrës- Shqipëri (Albania) Tel.: 052 223094 Fax: 052 22537
info@teutadurres.com www.teutadurres.com

Greqia në prag të fundit të afateve të pagesës së borxhit të saj

FMN përgatitet të paraqesë ultimatum, që funksionoi në Qipro, por situata është ndryshe

Dymbëdhjetë ditë. Ky është afati që Angela Merkel dhe François Hollande i kanë caktuar kryeministrit grek, për të arritur në një marrëveshje që të mundësonte zhblokimin e 7.2 miliardë eurove ndihma, pa të cilat Athina nuk mund të paguajë më paga e pensione. Dy udhëheqësit e Gjermanisë dhe Francës ditët e ardhshme do të takohen drejtpërdrejt me Alexis Tsiprasin në Riga të Letonisë, gjatë mbledhjes së kryetarëve të qeverive e shteteve të BE-së. Por është e dukshme që presioni mbi kryeministrin grek po rritet. U bënë katër muaj tashmë që nuk po ndryshon situata. Asnjë nga palët nuk po gjen një pikë të përbashkët, pavarësisht nga dhjetëra takime në nivel politik e teknik. Eurogrupi e sposito krizën në fund të majit, nga afati i mëparshëm që ishte shkurti dhe Grekja mundi ta zgjatë problemin e borxheve të saj deri në fund të qershorit. Por tanimë vërtet koha po skadon.

FMN Përballë lëkundjeve të qeverisë greke, po rrvijëzohet hipoteza e një ultimatum nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar, siç ndodhi në rastin e Qipros. Kjo e fundit u vu përpara një dileme: të ristrukturonte sistemin bankar dhe të merrte huatë, ose do të lihej në fatin e vet. Por Qiproja nuk kishte një borxh të përbindshëm prej 330 miliardë eurosh, si Greqia, prej të cilëve 80 për qind u detyrohet institucioneve publike evropiane dhe FMN-së. Një dokument i FMN-së pranon që Greqia nuk është në gjendje të kryejë pagesën e kështit të radhës më 5 qershor, që është me vlerë 7.2 miliardë euro. Dhe ky këst ka "ngrirë" që nga gushti i vitit të kaluar. Nisur nga kjo, Fondi i dha mundësinë e fundit Greqisë, që të përdorte edhe rezervat e saj monetare pranë FMN-së për të paguar kështin e mëparshëm, por tani edhe kjo mundësi u byll.



PO SI DO TË PROCEDOHE? Një nga mundësitë është që FMN, pa ndryshuar qendrimin e tij rigoroz lidhur me pagesën e detyrimeve, të kërkojë

▶ Bilokimi Një dokument i FMN-së pranon që Greqia s'është në gjendje të kryejë pagesën e kështit më 5 qershor, me vlerë 7.2 miliardë euro. Dhe ky këst ka "ngrirë" që nga gushti i vitit të kaluar

▶ Ndryshimi Ultimatum i FMN, që funksionoi në Qipro, vështirë të ecë në Greqi, që ka një borxh 330 miliardë euro, prej të cilëve 80 për qind u detyrohet institucioneve publike evropiane dhe FMN-së

që Evropa të ndihmojë Greqinë, duke përdorur fondin e krijuar pikërisht për krizën financiare të bankave të saj që nga viti 2010. Greqisë i janë bërë të gjitha lëshimet e mundshme, sidomos në fushën e taksave të brendshme, duke parë që është e pamundur të shtrëngohet më tej rripi i qytetarëve të saj pa krijuar një shpërthim të mëtejshëm social, për faj të qeverisjes së keqe të qeveritarëve paraardhës.

OPTIMISTËT Ndërkohë, ekipi i Inteligjencës Ekonomike të agjencisë Bloomberg mendon, nga ana tjetër, se Greqir duhet të ketë para edhe për gjithë muajin qershor. Ata e vendosin datën e dorëzimit të mundshëm të Tsiprasit në fillim të korrikut.

PËRFUNDIMI Kryeministri Alexis Tsipras vijon të shprehë optimist sa i përket arritjes së marrëveshjes mbi reformat me partnerët ndërkombëtarë brenda këtij muaji. Ai ka pranuar se deri më tani katër janë pikat ku nuk ka marrëveshje dhe që janë ato më thelbësoret: rregullat e punësimit, reforma e pensioneve, privatizimet dhe rritja e TVSH-së. Por, sipas tij, Evropa nuk do të pranojë të zgjedhë rrugën imorale, të shantazhit financiar, por atë të stabilitetit dhe sheshimit të pakënaqësive.

"EPIDEMIA"

Banka gjermane gati për largimin e Britanisë nga Bashkimi Evropian

Ndërkohë që skenarët e BE-së përgatiten për një dalje të mundshme të Greqisë nga zona euro, Deutsche Bank po merr në konsideratë zhvendosjen e disa prej operacioneve të saj në Britani, nëse kjo e fundit vendos të largohet nga BE. Kjo, nisur nga referendum, që David Cameron ka premtuar të organizojë brenda vitit 2017. Ky është giganti i parë financiar që merr në konsideratë mundësinë që të zhvendosë disa pjesë të biznesit mbarsht në Gjermani.

LAJME SHKURT



"Elita politike shqiptare, servile e Gruevskit"

Njëri prej organizatoreve të protestës së të hënës në Shkup, Petrit Saraçini, tha për emisionin "Rrokum Rroll" në TV Rrokum, se kjo protestë ishte organizuar nga shoqëria civile. Ai theksoi se elita politike shqiptare merret më shumë me interesa personale dhe është servile ndaj politikave të

Gruvskit. Saraçini tha se mediat në Maqedoni kanë dështuar në pavarësinë e tyre, duke shtuar se pothuaj të gjitha janë të politizuara. Saraçini ka paralajmëruar se shoqëria civile do të organizohet deri në atë masë, sa që do ta marrë politikën shqiptare në dorë.



JEMEN, 1'850 të vdekur dhe rreth 7'394 të plagosur

Dhuna në Jemen ka shkaktuar vdekjen e 1'850 personave, ndërsa 500'000 banorë janë larguar nga shtëpitë e tyre, tha dje zëdhënësi i OKB-së. Sipas Ocha-s, (organizëm i OKB-së që drejton situatat urgjente dhe që citon shërbimet shëndetësore në Jemen) ka rreth 7'394 të plagosur dhe 1'850 të vrarë. Adrian Edwards, zëdhënësi i komisarit të lartë për refugjatët, theksoi se numri i personave të zhvendosur që prej muajit mars ka arritur në më shumë se 545'000. Sipas tij, armëpushimi që përfundoi dje, i ka mundësuar HCR-së të dërgojë më shumë ndihma duke nisur nga qendra e shpërndarjes në Sana dhe Aden.

Mediat greke: Shqipëria pretendime territoriale

Kryeministri grek Tsipras do të vizitojë Tiranën në datën 26 maj në kuadër të Samitit të Procesit të Bashkëpunimit në Europën Juglindore (SEECP). Lajmin e bën të ditur gazeta "Greek Report", që ka disa ditë që shkruan lidhur me çështjen e pengon kërkimet greke për naftë në detin Jon. "Greek Reporter" ka shkruajtur se Shqipëria kërkon ndryshim të kufirit detar me Greqinë dhe kjo është e nxitur nga qarqet që duan "Shqipërinë e Madhe". Njësoj si "Kathimerini" edhe "Greek Reporter", ka theksuar se pas kësaj qëndron pikërisht Turqia.



Përmytje në Kolumbi, 57 të vdekur dhe qindra të zhdukur

Të paktën 57 persona kanë humbur jetën dhe 120 të tjerë janë zhdukur në Salgar, Kolumbi, pas rrëshqitjeve të tokës të shkaktuar nga shirat e rrëmbyeshëm. Rrëshjet e dendura të shiut shkaktuan daljen e disa lumenjve nga shtrati në këtë rajon. Shumë ndërtesa janë

shkatërruar tërësisht, ndërsa kërkimi për të zhdukurit është në vazhdim e sipër dhe ekziston mundësia që numri i të zhdukurve të rritet. Sipas informacioneve të marra, banorët e rrezikuar janë furnizuar me ujë të pijshëm dhe ushqim, ndërsa vazhdon evakuimi i banorëve më të rrezikuar.



BE, operacione ushtarake kundër trafikantëve në Mesdhe

Ministrat e Jashtëm dhe të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian miratuan nisjen e operacioneve ushtarake në Mesdhe kundër trafikantëve të qenieve njerëzore, raporton Anadolu Agency. Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për Punët e Jashtëm, Federica Mogherini, theksoi se operacionet do të fillojnë menjëherë në tre faza, mbledhjen e informacioneve, zbulimin e anijeve të trafikantëve të



qenieve njerëzore dhe asgjësimin e tyre. Ajo shtoi se shpreson që operacioni të nisë pas samitit të liderëve të BE-së që do të mbahet në qershor. Operacionet e emërtuar "EUNAVFOR Med" do të drejtohen nga italiani Enrico Credendino.

Afganistan, operacioni writen 60 talebanë

60 militantë talebanë janë vrarë dhe 38 të tjerë janë plagosur nga forcat e ushtrisë afgane në disa qytete të Afganistanit. Lajmi bëhet i ditur nga një deklaratë e publikuar nga Ministria e Brendshme e Afganistanit. Në deklaratë, thuhet gjithashtu se janë asgjësuar bombat e vendosura në anë të rrugës në disa qytete. Ndërsa në një deklaratë të bërë nga zëdhënësi i talebanëve, Zabihullah Muxahid në lidhje me konfliktet në fjalë është pretenduar se në rajonet Muxhagak dhe Mardijan të Xhevizhan është rrëzuar një helikopter, janë shkatërruar 4 tenake dhe janë vrarë 17 ushtarë afganë.



Pjesëmarrja/ Shqipëria kualifikohet e para me "I'm live"

Elhaida Dani në finalen e Eurovizionit

Këngëtarja 'elektrizon' skenën në Austri me zërin e saj, pretendente për çmimin e madh me këngën "I'm live"

IZAURA NDOJ
TIRANE

DHJETË VENDET E KUALIFIKUARA NË FINALE NGA GJYSMËFINALJA E PARË:

- Shqipëria
- Armenia
- Rusia
- Rumania
- Hungaria
- Greqia
- Estonia
- Gjeorgjia
- Serbia
- Belgjika

Emocione, kreshëri dhe entuziazëm na solli Elhaida Dani në skenën gjigante të Eurovizionit! Shqipëria është kualifikuar e para për në finalen "Eurovision 2015", kjo falë votimit të publikut që iu bashkangjiti edhe vlerësimi i jurisë profesioniste. Këngëtarja shqiptare Elhaida Dani ka elektrizuar skenën me zërin e saj, e cila u shfaq mjaftë e emocionuar, ndërsa stafi i saj shpërtheu në brohoritje për suksesin e prekur në gjysmëfinalen e parë. Përfaqësuesja e Shqipërisë, Elhaida Dani, është zgjedhur në grupin e dhjetë finalistëve të parë të edicionit të sivjetmë të Eurovizionit. Në gjysmëfinalen e parë të Eurosong konkurruan 16 këngë, ndërsa dhjetë prej tyre mbetën në garë. Kënga "I'm Alive" u këndua në renditje e 14-ta dhe siguroi numrin e mjaftueshëm të votave për të vazhduar në finale.

VLERËSIMET

Pas suksesit që Dani arriti të rrëmbente në skenën gjigante të Austrisë nuk kanë munguar as komentet pozitive në nder të saj. Artistë, politikanë, por edhe emra të njohur të skenës dhe ekranit nuk kanë ngurruar për të përgëzuar kualifikimin e Elhaida Danit në Eurovizion. "I'm live" duket se ishte një ogur i mirë për Shqipërinë në këtë kompeticion. Menjëherë pas performancës së Elhaida Danit në Eurovizion shpërthejnë komentet në rrjetet sociale. BBC ka komentuar shoqëruar me foto: "Shumë e këndshme të shohësh një vajzë këngëtare që nuk ka frikë nga një pelerinë pas "incidentit të Madonës" #Shqipëria #Eurovizion2015", shkruan BBC duke postuar një foto të Elhaidës në performancën e saj në skenë.

PRETENDETE PËR ÇMIM

Pjesëmarrja e Elhaidës në këtë festival është pritur me mjaft kërsheuri dhe entuziazëm, pasi Dani është diskutuar edhe si një nga pretendentet për të fituar këtë kompeticion muzikor. Ndonëse, në provën e parë në këtë event muzikor është diskutuar një prezantim jo me kapacitet të plotë të Danit, kualifikimi në finale tregoi të gjitha aftësitë e saj vokale duke shkëlqyer siç ka bërë në të gjitha eventet ku ka qenë pjesë, duke rrëmbyer duartrokitje dhe ovacione të shumta.



Lavdimi është i mirë kur nuk futet në këmbana të larta.

RELA

Ai që dëshiron të përmirësojë shoqërinë duhet të fillojë me veten.

LAGERLEFI

Mos vështro vetëm nga derdhet lumi, vështro edhe nga shkron.

SOXA

BASHA DHE VELIAJ

Pjesëmarrja në "Eurovizion" bashkon politikanët

Nata e parë gjysmëfinale e Eurovizion, ka angazhuar veç të tjerash edhe politikanët tanë, të cilët nuk kanë ngurruar të nxisin shqiptarët të votojnë për përfaqësuesen e tyre. Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha dhe kandidati i të majtës për bashkinë e Tiranës, Erion Veliaj, rrallëherë mund të bien 'në një mendje', por ditë të tilla me rëndësi kombëtare, bëjnë të pamundur të mundur! Të dy politikanët, 'kundërshtarë të betuar', kanë qenë 'aleatë' në nismën për të çuar Elhaidën drejt finales, duke ftuar të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë vendit, të votojnë numrin 14. Për të mbështetur Elhaidën, nuk kanë munguar as ish-kryeministri Sali Berisha, i cili e ka cilësuar si ambasadorin e vendit tonë.



KËNGËTARI

Getoar Selimi me 'të kuqe', i hiqet patenta

Rreperi i famshëm kosovar i njohur si Getoar i Tingullit Trent me emrin e tij Getoar Selimi është penalizuar në Tiranë me heqje patente dhe 25.000 lekë gjobë. Shkak për këtë masë ndaj reperit është bërë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, ku këngëtari është futur me të kuqe në semaforin pranë kryeministrisë në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Sikur të mos mjaftonte futja me të kuqe, Getoari nuk i është bindur policit për të ndaluar çka ka sjellë më pas dhe shoqërimin e tij në komisariat. Aktualisht Getoari është lënë i lirë, dhe pritet që patenta t'i hiqet për të paktën 6 muaj sipas rregullave të reja.



Rubrika

SHËNDETI

LEXIM I LEHTËSUAR

Për të ndihmuar njerëz në moshë të thyer rubrika "Shëndeti" botohet me gërmë më të madhe për të lehtësuar leximin



Ristë



Djathi i bardhë

"Ka rreth 75 gr kalori, nivel jo të lartë yndyrne, proteina biologjike dhe lëndë që kanë përmbajtje kalciumi. Përmban sasi të larta të natriumit, që ndikojnë për forcimin e kockave"



Mishi i kalit

Pavarsisht se ende në Shqipëri nuk ka një ligj i cili të lejojë konsumimin e mishit të kalit, sipas studimit të OBSH-s, mishi i kalit forcon muskujt e njeriut u jep atyre më shumë energji



8 ushqimet dhe perimet që duhet të konsumoni



"Luleshtrydhja lehtëson prodhimin kolagenit, një proteinë që pengon rrudhat dhe forcon kapilarët të cilët nuk lejojnë zhvillimin e celulitit"

DRIÇIM ÇAKA
TIRANE

Një kombinim i duhur i ushqimeve mund të sjellë rënien në peshë, parandalimin e shumë sëmundjeve, por më e rëndësishme mbrojnë lëkurën nga plakja. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në një studim të saj ka renditur 8 ushqimet që duhet të konsumohen nga çdo individ.

LIMONI

Limoni përmban 22 kombinime anti-kancer, duke përfshirë një vaj natyral që ngadalëson apo edhe ndalon rritjen e tumoreve. Limoni është i pasur me vitaminën C, të dobishme për të neutralizuar plakjen e shpejtë. Gjithashtu limoni përdoret për të luftuar infeksionet në mëlçi dhe në stomak. Po kështu limoni këshillohet në të gjitha dietat që përdorin njerëzit.

VEZA

Për fëmijët dhe të moshuarit për të mbajtur të fortë muskujt këshillohet konsumimi i vezëve çdo ditë. Veza ka disa acide të veçanta, të cilat mbrojnë kockat dhe rritin qëndrueshmërinë e tyre. Gjithashtu veza përmban "choline", një substancë për qelizat nervore që ndikojnë në zhvillimin e trurit dhe në rritjen e kujtesës.

PERIMET

"Selino, kungull i njomë, borkoli, lakër, karrota, luleslakër, qepë, kërpudha, sallatë jeshile, patëllxhan, specia, domate (salcë dhe lëng)", - janë disa nga perimet që janë të domosdoshme për njeriun. Këto perime rriten rezistencën e muskujve, forcojnë kockat dhe japin efekt në zhvillimin e trurit të njeriut.

DJATHI I BARDHE

Organizata Botërore e Shëndetësisë e rendit djathin grek (feta), si një

ndër produktet e bulmetit më të mirë në botë. "Ka rreth 75 gr kalori, nivel jo të lartë yndyrne, proteina biologjike dhe lëndë që kanë përmbajtje kalciumi. Përmban sasi të larta të natriumit dhe fosforit, që ndikojnë për forcimin e kockave", - thuhet në studimin e OBSH-s.

LAKRA

Është renditur si një ndër perimet më të mira për të mbajtur trupin në formë, për të mbajtur dietë, për të ulur kolesterolin, për të rregullur presionin e lartë të gjakut etj. Lakra ka përmbajtje të lartë ushqimore, sidomos për fëmijët dhe të moshuarit. Po kështu lakrat përmbajnë minerale të ndryshme, që trupi i njeriut duhet ti konsumojë çdo ditë.

LULESHTRYDHE

Lehtëson prodhimin kolagenit, një proteinë që pengon rrudhat dhe forcon ka-


pillarët të cilët nuk lejojnë zhvillimin e celulitit. Luleshtrydhja ka përmbajtje të lartë të vitaminës C si dhe nxit thithjen e hekurit nga ushqimet e tjera. I quajtur "fruti i kuq", luleshtrydhja nuk lejon krijimin shtresave të dhjamit në trupin e njeriut.

PIPERI ZI

Piperi i zi nxit qarkullimin e gjakut në trupin e njeriut dhe mbron sistemin kardiovaskular. Po kështu piperi i zi ndihmon për të mbajtur në nivelin e duhur kolesterolin. Piperi i zi ka disa acide yndyrore të cilat forcojnë enët e gjakut.

MISHI I KALIT

Në Itali mishi i kalit është ndër mishrat më të konsumuar në treg. Pavarsisht se ende në Shqipëri nuk ka një ligj i cili të lejojë konsumimin e mishit të kalit, ekspertët shpjegojnë se është shumë e rëndësishme për njeriun. Sipas studimit të OBSH-s, mishi i kalit forcon muskujt e njeriut si dhe i jep atyre më shumë energji.



**MJEKËT
STUDIMET**



Britani
Mjekët në Britaninë e Madhe kanë arritur në përfundimin se vaksina e fëmijëve nuk ka rrezik për efekte anësore. Mjekët këshillojnë prindërit të mos kenë frikë për të vaksinuar fëmijët

Pilula
Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka filluar përdorimi i një ilaçi i cili mendohet se ndikon në ngadalsimin e kancerit. Ilaçi është zbuluar nga një grup shkencëtarësh të rinj në SHBA

Portokalli
Portokalli është një frut i cili duhet të konsumohet çdo 2 ditë. Kështu këshillojnë disa studiues në Britani, të cilët e shohin si një mundësi për të ruajtur kujtesën kur të plakni

Qershia
Kjo është koha e qershive dhe studiuesit këshillojnë, që të konsumohet çdo ditë. Qershia ndikon në përmisimin e qarkullimit të gjakut dhe mbron nga ataku në zemër



Metodat për të hequr yndyrnat e tepërta

Njeriu është mbipeshë kur merr më shumë energji sepe trupi e grumbullon këtë energji në formë dhjami

Konsumimi i shumë yndyrnave sjell dhe shtimin në peshë të njerëzit. Por çfarë duhet bërë që të largosh yndyrnat e tepërta? Dietologët këshillojnë që të mbahet një rregull në ushqim. Për shembull nuk duhet konsumuar ushqime si galpi ose margarina që janë tërësisht yndyrna të pastra. Po kështu duhet që njerëzit të orientohen drej produkteve bimore. Një tjetër këshillë është që të gesh një punë. Nëse konsumoni gjatë ditës disa lloj yndyrnash dhe rutina ditore vazhdon nga shtëpia në kafe, atëherë mos kërkoni që të hiqni peshën e tepërt. Këshillohet që të gjeni një punë si dhe ta lini në shtëpi makinën.



për dhjamë të fshehur, që është ai dhjam që nuk mund të shihet direkt me sy (për shembull është e vështirë të shikohet se sa dhjam ka në djathë që mund të përmbaj nga 10 % deri në 80 % yndyrë). Prandaj është mirë që të lexohet përbërja sa yndyrë ka në produktin ushqyes përkatës. Ushqimi i përpunuar industrialisht nuk është më i keq se ushqimi i gatuar në shtëpi, por duhet pasur parasysh që dhjami është më i lirë se mishi dhe prandaj për prodhuesit është me interes që të shkëmbejnë pjesë të mishit me dhjam. Nuk është shumë e shëndetshme që të hash shumë yndyrë. Midis të tjerave është shumë e pashëndetshme për enët e gjakut në trup të ekspozohen nga shumë yndyra, sepe yndyra mund të grumbullohet në muret e enëve të gjakut dhe në këtë mënyrë rritet rreziku për bllokimin e enëve të gjakut, prej të cilave njeriu mund të vdesë. Ndër të tjerash sasia e madhe e yndyrës në ushqim bën që njeriu të peshojë shumë. Njeriu është mbipeshë kur merr më shumë energji, sesa ka nevojë, sepe trupi e grumbullon këtë energji ekstra në formë dhjami rreth barkut ose vende të tjera në trup.

KËSHILLAT

Duhet që njerëzit të orientohen drej produkteve bimore. Një tjetër këshillë është që të gesh një punë. Nëse konsumoni gjatë ditës disa lloj yndyrnash dhe rutina ditore vazhdon nga shtëpia në kafe, atëherë mos kërkoni që të hiqni peshën e tepërt

NIVELI

"Yndyra mund të grumbullohet në muret e enëve të gjakut dhe në këtë mënyrë rritet rreziku për bllokimin e enëve të gjakut, prej të cilave njeriu mund të vdesë. Ndër të tjerash sasia e madhe e yndyrës në ushqim bën që njeriu të peshojë shumë"



Tri këshillat kryesore



Palestra

Stërvitja në palestër për më shumë se 1 orë, si për femrat dhe për meshkujt mund të sjellë probleme serioze në funksionimin e organeve jetësore. Kështu thuhet në një studim të "Oksford University"



Fizioterapisti

Të vraposh është pjesa më e rëndësishme për të ndikuar në forcimin e muskujve dhe kockave, por kur zhvillohet vrap i përditshëm këshillohet që të bëhet dhe vizitë të fizioterapistit



Muskujt

Çdo njeri duhet të dijë gjendjen në të cilën ndodhen muskujt e tij, në rast se zhvillon stërvitje ose vrapon. Këshillohet që muskujt të mbahet në gjendje të mirë duke u vizituar te mjeku

STUDIMI

Mjekët në vend të ilaçeve mund tu japin drogë



Sipas një studimi në Britaninë e Madhe të moshuarit janë të presdizpozuar për të marrë çdo ilaç ju jep mjeku, pavarësisht se mund të kenë efekte anësore. Disa studiues këshillojnë që ilaçet të mos konsumohen në sasi të mëdha pasi mund të krijojnë

përmbajtje droge në bashkëpunim me njëri-tjetër. Studiuesit arritën të vërtetonin se një ilaç për kolesterolin, një medikament për zemrën, një qetësues për kokën dhe që ilaç për sytë, nëse konsumoheshin të katër gjatë një dite, atëherë krijohej një drogë e lehtë.

Studimi zbuloi një tjetër fakt tronditës, atë të krijimit të kancerit nga këto ilaçe që krijojnë drogën. Studimi i cili ka për qëllim të prezantohet Organizatës Botërore të Shëndetësisë, këshillon mjekët që të kenë kujdes me dhënien e ilaçeve te pacientët.

KAPLLAN RESULI

"TRADHËTIA", ROMANI QË DYSHOHEJ SE JEPTE TË DHËNA SEKRETE PËR UDB-NË

50-vjetori i krijimit të një vepre plot peripeci me politikën e kohës së Hoxhës... Si u shkruajt në vitet e internimit në Çermë të Lushnjës, peripeci me botimin dhe ndërhyrjet e shumta në vepër...

EMER MBIEMER
TIRANE

Akademiku Kapllan Resuli nuk hyri rastësisht në plejadën e shkrimtarëve të shquar shqiptarë. Ate e ngriti aq lart dhe e bëri të pavdekshëm në mendjen dhe zemrën e kombit shqiptar vepra e tij. Pa dyshim, vepra që e bëri të njohur dhe të nderuar për lexuesin shqiptar shkrimtarin e talentuar Kapllan Resulin ishte romani TRADHTIJA. Kjo vepër e gjen zanafillën në kampin e përqëndrimit të të burgosurve në Idrizovo, rreth 10 km larg Shkupit, ku edhe lindi dhe u strukturua si vepër e si roman.

Resuli qysh me kohë kishte dëgjuar për Abdullah Krashicën, të quajtur edhe Abdullah Presheva një patriot kosovar. Kur arriti si i burgosur politik në Idrizovo, gjeti aty të dënuar politikë shumë nga shokët e luftës të Abdullah Preshevës, komandanti e komisarë repartesh partizane, po dhe partizanë më të thjeshtë. Ata i folën më lirisht për komandantin e tyre, Abdullah Preshevën, sidomos kur u siguruan se tek Kapllan Resuli mund të besonin.

Duke dëgjuar bisedat e tyre për Kosovën, atdheun, lirinë, Profesor Resuli i lindi ideja për të shkruar diçka për Abdullah Preshevën, ndonjë reportazh, si ai që tashmë e kishte shkruar e botuar për majorin sloven Anton Pristov. Sa më shumë që dëgjonte e më shumë i forcohej ajo ide, që dalngadalë nisi t'i formulohet si tregim, pastaj si novelë dhe, më në fund, edhe si roman.

Kështu, nga fundi i vitit 1959, Profesori e kishte krijuar skemën strukturorë dhe konceptin e parë të atij romani. Muajt e parë të vitit 1960 një të diele ai i mblodhi të burgosurit politikë me të cilët kishte muhabet, dhe ua tregoi subjektin e romanit fill e për pe dhe me atë rast dëgjoi vërejtjet e tyre dhe ditët që vijuan e korigjoi dhe e plotësoi kryeveprën e ardhshme.

Me që në fillim të gushtit të atij viti do të lirohej nga burgu intelektual nga Gostivari Adnan Agai, ai thërret menjëherë dhe i pati thënë:

- Shiko Kapllan, pas një muaji duhet të lirohem edhe unë. Po siç po shkojnë punët këtu, kësaj historie të trishtë nuk i dihet, sepse ti po e sheh se vazhdimisht kurdisin plane



Romani i gjymtuar Pas shumë peripecish, vështirësish, sabotimesh, kontrollësh të repta e analizash meskine, më në fund, në faqet e gazetës "Libri" qe botuar njoftimi se "Së shpejti do të botohej novela "Tradhëtia" e Kapllan Resulit". Kërkohej të quehej novele, pastaj nga 392 faqe veprës u hoqën rreth 100 faqe...

kundër nesh. Ka mundësi që të më qesin prap në gjyq e të më dënojnë. Bile, ka mundësi që të më eliminojnë edhe mua fizikisht siç u perpoqen të të eliminojnë edhe ty. Nuk më vjen keq do të vdes, por më vjen keq se mund të mbetet pa u shkruar e botuar romani për Abdullah Preshevën. Prandaj të lutem, po more vesh se nuk jam gjall, ulu e shkruaje ti këtë roman.

Pas kësaj ai ia pati ritreguar edhe një herë ngjarjen ashtu siç e kishte

konceptuar në mendje. Po, pas një muaji, Profesorin e liruan nga burgu. Atëherë A.Agai i kishte thënë:

-Tash Pofesor keni mundësinë të uluni e ta shkruajeni ju romanin për Abdullah Preshevën!

Pas disa ditësh Profesorin u arratis në Shqipëri. Autoritetet shqiptare, për të gjitha ato të mira nga më të shquarat, që ia kishte kontribuar popullit shqiptar, për të gjitha sakrificat e tij nga më sublimet, në shenjë mirënjohjeje dhe falen-

derimi e patën përplasur në kampin e përqëndrimit të emigracionit jugosllav në Çermë, ku nuk kishte mundësi për të bërë një jetë më të thjeshtë e normale, e jo më edhe për t'u marrë me shkrime.

Po Profesori tashmë gëzonte një vullnet të hekurt dhe shpresonte tek e ardhmja, prandaj përpiqej të ingranohet në jetën e përditëshme me talentin të tij të padiskutueshëm prej krijuesi, përmes penës së tij të artë. Me gjithë pengesat e panumruta që i dilnin përpara, ai menjëherë lu shtrua punës dhe nisi të shkruante romanin. Dihet se tavolinë e karrike nuk kishte, madje as laps e leter normale. Në kapononin ku flinte, kishte edhe rreth 100 të internuar të tjerë, që vazhdimisht lëviznin, hynin e dilnin jo vetëm ditën, por edhe natën.

Në vend të tavolinës, një nga shokët e tij improvizoi aso kohe një copë kompensatoje, të cilën profesori e mbështeste mbi gjunj, duke qenë i ulur në shtrat. Këtu e kështu pati nisur të shkruhej një nga kryeveprat e letërsisë sonë,romani "TRADHTIJA".

Ndërkohë, duke shkruar romanin TRADHTIJA, këtë kryevepër të letërsisë shqiptare, pareshtur shkruante e botonte edhe vepra të tjera, sidomos për trupën e estradës dhe të teatrit të emigracionit. Në shtypin e kohës fare pak i botonin krijime profesorit, sepse veprat e tij po linin nën "hije", po eklipsonin veprat e shkrimtarëve të realizmit socialist. Me gjithë pengesat më evidente, talenti dhe shkathtësia e tij depërtuan edhe në organet qëndrore e kryesore të shtypit letrar të kohës. Kështu në revistën "Nëntori", nr. 6/1962, iu botua tregimi "Mejremja", ndërsa në revistën "Ylli", nr.2/1963, i botohet vjersha e parë në shtypin shqiptar me titull "Betimi", e më tej në gazetën "Drita" tregimi "Bursa".

Sapo e mbaronte ndonjë kapitull të romanit, i thërriste emigrantët me të cilët kishte muhabet, dhe ua lexonte. Kështu, një numër i tyre, e dëgjuan romanin TRADHTIJA jo vetëm pa u botuar, por edhe pa u përfunduar ende së shkruari. Mes atyre, që më shpesh kanë dëgjuar leximin e kapitujve të romanit, kanë qenë Nazmi Berisha (që e ka pranuar këtë gjë edhe në librin e tij kushtuar jetës së Profesorit !), pastaj Ahmet Sadiku, Namik Luci, Bajram Tigani, Nexhat Kërnya, Hysen Belegu, Ymer Kelmendi, Ibrahim Gjonbalaj dhe

Gjonbalajt e tjerë. Ndonjeri prej tyre menjëherë e pati mësuar ndonjë fragment edhe përmendësh, kurse Hyseni, që edhe flinte pranë Profesorit, duke dëgjuar për personazhet katolike, të romanit, krijoi bindjen se edhe Kapllan Resuli mund të ishte i krishterë, bile dhe katolik.

Në verën e vitit 1962 romani ishte gati, i shkruar me dorë nga Kapllan Resuli në disa fletore, sepse makinë shkrimi i nuk kishte. Në shtator të po atij viti Profesorin e liruan nga kampi, dhe e patën transferuar në qytetin e Lushnjës, po prap me statusin e të internuarit, bile pa i siguruar banesë dhe pa punë. Atëherë, për herë të parë, e lejuan Profesorin të shkonte deri në qytetin e Shkodrës, për të parë të motrën dhe njerëzit e sajë. Duke shetituar në rrugën kryesore të qytetit, i tërhoq vemendjen në vitrinën e një dyqani një makinë shkrimi portabël, të markës EVEREST, që kushtonte 10 mijë lekë. Pofesori nuk kishte lekë në xhep. Motra e tij i pati gjetur hua parat tek kushërinjtë dhe Profesorin kështu u bë me makinë shkrimi për herë të dytë,sepse makinën e parë të shkrimit e kishte blerë në Tetovë, në vitin 1958, para arrestimit.

Sapo u kthye në Lushnjë, ai i hyri punës për ta daktilografuar romanin. Duke e daktilografuar i bëri aty këtu edhe ndonjë korigjim apo ndonjë shtesë. Nga fundi i vitit 1962 romanin ia pati nisur me postë Ndërmarrjes Botuese "Naim





Frashëri" në Tiranë. Ndërmarrja Botuese, ose më saktë, ata që qëndronin pas asaj ndërmarrjeje, ia bllokoi romanin pa asnjëfarë arsye, pa i kthyer përgjigjeje për më shumë se një vit, diku deri në fillim të vitit 1964. Atëherë ia kthyen veprën me kërkesën absurde që t'i hiqte të gjithë emrat e vërtetë, si dhe disa pjesë apo kapituj, sidomos lidhur me kombin maqedon e organizatën e tyre antiturke VMRO.

Kështu, në vitin 1964, në vend që të projektonte dhe të shkruante ndonjë roman tjetër, iu desh rishitas të merrej me romanin TRADHTIJA, ta ripunonte e ta daktilografonte, pa patur asnjë kusht të favorshëm për punë, pa tavolinë e pa karrike, në qytetin e Lushnjës, në një barakë të vjetër në lagjen "Loni Dhamo", Aso kohe profesori ishte angazhuar shpirtërisht në mësimdhënie, sepse sakrifikonte duke shkuar në këmbë çdo mëngjes në fshatin Karbunarë, ku jepte mësimin e matematikës, para ditë në tetëvjeçaren e të vegjëlve dhe pasdite, deri në orën 8 të mbrëmjes, në shkollën e natës për të rriturit që në atë kohë sapo ishte hapur.

Në maj të vitit 1964 Profesori ia nis perseri romanin NB "N. Frashëri". Me urdhër të KQ të PPSH-ës ndërmarrja ia kalon veprën Lidhjes së Shkrimtarëve. Nga shkrimtari Dhimitër Xhuvani, pas disa muajsh, Kapllan Resuli merr vesh se romani i tij ishte ekspozuar në një dhomë sekrete të Lidhjes së Shkrimtarëve, ku persona të autorizuar shkonin, e

Në skaner Me urdhër të KQ të PPSH-ës ndërmarrja ia kaloi veprën Lidhjes së Shkrimtarëve. Romani i tij ishte ekspozuar në një dhomë sekrete të Lidhjes së Shkrimtarëve, ku persona të autorizuar shkonin, e lexonin dhe i raportonin Lidhjes për çdo gjë të dyshimtë, si dhe jepnin mendime për vlerat ideo-artistike të veprës.

lexonin dhe i raportonin Lidhjes për çdo gjë të dyshimtë, si dhe jepnin mendime për vlerat ideo-artistike të veprës. Dyshohej se mos ishte Kapllani agjent i UDB-së dhe se përmes romanit të tij i raportonte të dhënat sekrete të mbledhura në Shqipëri.

Së fundi i thirrën Profesorin nga Lushnja në Tiranë, në NB "N. Frashëri" dhe i kërkuan që urgjentisht ta zgjeronte pak EPILOGUN e veprës. Profesorit as që i shkente mendja se për çfarë qëllimi bëhej kjo, dhe nuk mendonte se ata dyshonin se mos nuk ishte ai autori i asaj veprë!

Mori epilogun dhe shkoi në Qytetin "Studenti", në një dhomë të konviktit, ku ishin disa studentë, mes tyre edhe dy-tre, që më vonë do të afirmohen edhe ata si shkrimtarë. Ishin Kiço Blushi dhe poeti i ardhshëm Ndoc Gjetja. Aty, në sytë e tyre profesori pati qendësuar nga e para epilogun e romanit në fjalë dhe që të nesërmen

në mëngjes ia pati dorëzuar ndërmarrjes botuese "N. Frashëri".

Kështu, pas shumë peripecish, vështirësish, sabotimesh, kontrollesh të rrepta e analizash meskine, më në fund, në faqet e gazetës "Libri" që botuar njoftimi se "Së shpejti do të botohej novela "Tradhëtia" e Kapllan Resulit". Kërkohej të quehej novele, pasi nga 392 faqe që kishte shkruar autori me 1962, veprën iu hoqën rreth 100 faqe dhe më në fund në maj të vitit 1965 libri doli nga shtypi me 259 faqe. Madje duke e shkurtuar dhe masakruar kështu, romanit i ishte bërë edhe një gabim teknik shumë i rëndë, që autori do ta korigjonte pas shumë vitesh, në botimin e dytë, pa fjalë dhe pa u ankuar.

Akademiku, prof. dr. Kapllan Resuli ka filluar të shkruajë e të botojë në gjuhën serbo-kroate dhe ka vazhduar edhe në të gjitha gjuhët e tjera, që ndërkohë i ka zotëruar mirë

rreth dhjetë gjuhë. Shumë shpejt që afirmuar dhe që bërë anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Jugosllavisë dhe më vonë edhe anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Cërna Gorës, Zvicrës, anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve Serbë në Zvicër. Profesori njihet jo vetëm si shkrimtar, por edhe si publicist, bile edhe si shkencëtar, ballkanolog, veçanërisht si albanolog. Si të tillë e kanë përfshirë në shumë LEKSIKONE, ËIKIPEDA, bile edhe në shumë ENCIKLOPEDI të popujve dhe shteteve të ndryshme. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës e Shqipërisë do ta fuste për pak kohë edhe në programin zyrtar për shkollat e të gjitha kategorive, si dhe në Programin e letërsisë në Universitet. Kapllan Resulin, më saktë zbulimin e tij shkencor nga fusha e fonetikës shqiptare, do ta gjeni edhe në FJALORIN ENCIKLOPEDIK SHQIPTAR, por pa emrin e saktë të tij, sese në atë kohë ai ishte i arrestuar.

Romanin TRADHËTIJA Kapllan Resuli e ka shkruar në gjuhën shqipe, saktësisht në gegërisht. Vetë forcat shkencore dhe krijuese shqiptare, bile jo kushdo, por arsimtarët e gjuhës shqipe të mbledhur në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, e kanë shpallur librin e tij si kryevepër të letërsisë shqiptare në prozë, bile është quajtur UNGJILLI i patriotizmit shqiptar, ndërsa gjuhën e kësaj romani e patën propozuar si gjuhë zyrtare, kombëtare. Me gjithë persekutimet më skandaloze, që i

janë bërë dhe vazhdojnë t'i bëhen sot e kësaj dite kësaj veprë nga qeveritë shqiptare kohë pas kohe dhe njerëzit e indoktrinuar me të tipit enverist, romani ka arritur të botohet plot pesë here.

Ja botimet që i janë bërë në kohë të ndryshme këtij romani:

- Botimi i parë: Tiranë 1965, Shtëpia Botuese „Naim Frashëri“, tirazhi 5000 kopje, formati 78 x 109/32, faqe 259, Shtypshkronja „Mihal Duri“, redaktore: Donika Omari, korrektore: Neka Turkeshi, piktor: Ksinofon Dilo, redaktor teknik: Adem Lita.

Njihet si botimi zyrtar i Qeverisë Shqiptare dhe i Partisë së Punës të Shqipërisë, i bërë me leje të veçantë nga KQ i PPSH-ës, pas kontrollit të imtë dhe special të ekspertëve të KQ dhe të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, ndër të cilët deri më sot autori ka arritur të identifikojë: Ramiz Alinë, Ismail Kadarenë, Dritëro Agollin, Ibrahim Uruçin, Sterjo Spassen, Dhimitër Xhuvanin dhe Nasho Jorgaqin. Në libër shkruhej se tirazhi ishte 4000 kopje, por nga burime kofinanciale thuhet se janë botuar edhe 1000 kopje të tjera që janë futur ilegalisht në Kosovë.

Menjëherë pas botimit të veprës Kapllan Resuli që pranuar Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, por vetëm formalisht, pa asnjëfarë të drejte. Bile vite me radhë nuk i njohën as të drejtën e orarit të reduktuar që i takonte si anëtar i Lidhjes. Edhe ato pak leje krijuese që i jepnin, sistematikisht ia patën sabotuar për ta penguar në punën krijuese.

Në këtë botim u hoqën të gjitha faqet e veprës që flisnin për kombin maqedonas dhe organizatën e atëhershme antiturke dhe antijugosllave VMRO. Dyshohej të jenë futur fraza dhe mendime që synonin të ruanin të ashtuquajturin "bosht ideologjik të partisë", për të cilat autori pati protestuar në shumë intervista që pati dhënë pas daljes nga burgu. Vlera te veçanta romanit i shton gegërishtja e përdorur me mjeshhtëri si gjuhë e pastër dhe e pa arritshme, në kundërshtim me "porositë e dhëna nga autoritetet" e shtetit komunist.

- Botimi i dytë - i ripunuar: Doli në Tiranë në vitin 1967, Shtëpia Botuese „Naim Frashëri“, tirazhi 20.000 kopje, formati 78 x 109/32, faqe 392, Shtypshkronja „Mihal Duri“, redaktore: Donika Omari, korrektor: Xhevat Lloshi, kopertina: Robert Ballauri, redaktor teknik: Adem Lita. Me parathënie të prof. dr. Adriatik Kallullit.

Edhe ky ishte botim zyrtar i Qeverisë Shqiptare dhe i Partisë së Punës së Shqipërisë, i bërë me urdhër të KQ të PPSH-ës, e në bazë të kërkesave të shqiptarëve në Shqipëri dhe në diasporë.

Në këtë botim, me kërkesën këmbëngulëse të autorit, janë shtuar disa nga pjesët që janë lënë jashtë veprës në botimin e parë nga redaktorja (sigurisht me urdhër të KQ të PPSH-ës!) si dhe disa korigjime dhe plotësime që ndërkohë, iu bënë nga vetë autori. Libri i është shtuar edhe dedikimi ndaj fëmijëve të autorit Arbenit dhe Arbanës. Në libër shkruhet se tirazhi është 15.000 kopje, po janë botuar edhe 5.000 kopje të tjera, që janë futur ilegalisht perseri në Kosovë.

(Vijon nesër...)

Promovimi/ Më 29 maj do të zgjidhen organet drejtuese

Krijohet shoqata në mbrojtje të Drejtshkrimit

Ngritja e saj merr shkas nga debatet e çelura në Këshillin Ndërkademi për Gjuhën Shqipe për ndryshimet në Drejtshkrim

DHURATA HAMZAI TIRANE


Promovimi i librit të Preng Çub Leshit që mban titullin "Mos e vritni fjalën shqipe", do të jetë një ndër aktivitetet e para të shoqatës së sapokrijuar të Gjuhësisë Shqiptare në Tiranë. Shoqata do të bëjë paraqitjen e librit të autorit Preng Çub Leshi ditën e premte, më 29 maj 2015, ora 11.00 në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja.

Preng Çub Leshi, së bashku me gjuhëtarët e tjerë të shquar si Mehmet Çeliku, Rahmi Memushaj, Emil Lafa, Xhevat Lloshi, Shpëtim Çuça, Rexhep Ismajli e Shefkije Islamaj, kanë ngritur zërin në media kundër prekjës së normave të Drejtshkrimit. Protestat kanë qenë të shumta pas një debati të madh gjuhësor dhe konfliktëve me anëtarëve të Këshillit Ndërkademi për Gjuhën Shqipe, që propozoi ndryshime në Drejtshkrimin e Shqipes. Preng Çub Leshi ka qenë edhe një ndër delegatët e Kongresit të Drejtshkrimit në vitin 1972, ku në bazë të vendimeve të këtij kongresi u zyrtarizuan normat gjuhësore të shqipes. Kështu ai ka përmbledhur në këtë libër argumentet se pse nuk duhen cenuar këto norma.

RAMI MEMUSHAJ: JA OBJEKTIVAT E SHOQATËS

Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare është themeluar nga një grup nismëtarësh, studiuesish e pedagogësh shqiptarë të fushave të ndryshme të gjuhësisë, si një organizim me përfaqësim të gjerë mbarëkombëtar. Themeluesit e kësaj shoqate janë Emil Lafa, Xhevat Lloshi, Rami Memushaj, Shpëtim Çuça, Kujtim Kapllani.

Shoqata është regjistruar me vendimin nr. 3925, datë 9.07.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në cilësinë e kryetarit aktualisht është profesor Emil Lafa. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare si objektivi kryesor të saj ka mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe Drejtshkrimin të saj. Një vit pas iniciativës për ngritjen e kësaj shoqate, tashmë ajo ka fituar të drejtën ligjore për të ushtruar aktivitetin e saj. Më 29 maj kjo shoqatë do të zgjedhë edhe kryesinë e saj pas çeljes së aktivitetit nga prof. dr. Emil Lafa dhe diskutimeve që do të mbahen për problemat aktuale të gjuhës



shqipe nga Rami Memushaj, Xhevat Lloshi, Shpëtim Çuça, etj.

Një nga iniciatorët e themelimit të Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare, Rami Memushaj pohon për "Shqiptarja.com" se "Shoqata ka për qëllim mbrojtjen e pasurisë gjuhësore të trashëguar, studimin e shqipes së sotme standarde dhe sigurimin e mundësive për zhvillimin e qëndrueshëm të saj, përmirësimin e mësimdhënies së gjuhës shqipe, ngritjen e kulturës gjuhësore në shtyp, në botime e në ligjërimet publike".

Memushaj kujton se shoqata gjuhësore të ngjashme ka në shumë shtete të botës, mjafton të kujtojmë Akademinë gjuhësore Della Crusca të Italisë, të krijuar në vitin 1583; Shoqatën Gjuhësore të Parisit, të themeluar më 1864, ose Shoqatën Gjuhësore të Amerikës, të themeluar në vitin 1924, e cila ka pasur në gjirin e saj gjuhëtarët më në zë të ShBA-së. "Shoqata jonë e ka nisur veprimtarinë që

vitin e kaluar, duke organizuar paraqitje botimesh për gjuhën shqipe dhe po vijon edhe këtë vit me paraqitjen e një botimi tjetër të kohëve të fundit. Megjithatë, ajo është ende në fazën e konstituimit të organeve drejtuese të saj dhe të zgjerimit të anëtarësisë me anëtarë nga të gjitha trojet, në radhë të parë, nga institutet e gjuhësisë dhe nga departamentet e gjuhës të të gjitha universiteteve tona këtu, në Kosovë dhe në Maqedoni", pohon Memushaj.

Ndërsa sipas prof. Emil Lafa, ndër planet afatshkurtra të Shoqatës janë, së pari, botimi i një reviste 6-mujore që do të shërbejë njohjes së arritjeve të gjuhësisë shqiptare dhe ngritjes së kulturës gjuhësore të folësve; së dyti, organizimi i leksioneve verore të hapura dhe falas për të gjithë ata që kanë interesa gjuhësorë; dhe, së treti, ndërgjegjësimi i organeve shtetërore për kujdesin që duhet treguar për gjuhën. Ndërsa për mungesën aktuale të kujdesit për gjuhën prof. Rami Memushaj ka shumë vërejtje. Ai thotë se "Për kujdesin ndaj gjuhës i kemi sugjeruar që vitin e kaluar Ministrisë së Arsimit pajisjen falas të nxënësve nga klasa e pestë deri në klasën e dymbëdhjetë me fjalorin e gjuhës shqipe, si libër ose në versionin elektronik; do të kërkojmë edhe miratimin e Ligjit për gjuhën, një projekt i të cilit fle në Kuvend prej vitit 2005". Sipas prof. Memushaj, "miratimi i këtij ligji bëhet i domosdoshëm jo vetëm se kujdesi shtetëror për gjuhën është në pikën më të ulët, pasojat e mungesës së të cilit i shohim të gjithë përditë, po edhe sepse një ligj për gjuhën pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Do të duhej që, në përpunje me parimet e shpallura nga qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës për afrimin kulturor të të dy pjesëve të kombit, të kishte një qëndrim të përbashkët e të njëjtë edhe për këtë pikë, duke qenë se gjuha standarde është pasuri e përbashkët e ngritur me mundin dhe përpjekjet e përbashkëta të gjuhëtarëve dhe të lëvruarve të shqipes në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi", theksoi prof. Rami Memushaj për "Shqiptarja.com".

MK ENDE S'KA ÇELUR KONKURSION

Teatri i Operës mbyllet në qershor për restaurim

Godina e TKOB-it mbyllet në qershor. Punonjësit e Ansambllit janë lajmëruar për t'u zhvendosur në Universitetin e Arteve për të zhvilluar provat. Por nuk dihet se kur do të mundet restaurimi, sepse Ministria e Kulturës disa herë e ka shtyrë hapjen e konkursit ndërkombëtar për projektet restauruese. Konkursi kombëtar nuk është çelur ende në faqen zyrtare të institucionit. Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit në Tiranë është një nga institucionet kulturore më të rëndësishme të vendit. I frekuentuar, jo vetëm nga qytetarët e Tiranës, por edhe nga një publik më i gjerë nga përfaqësitë diplomatike ndërkombëtare apo turistët e ardhur në Tiranë, ambjentet e këtij institucioni nuk kanë ofruar komoditetin e nevojshëm. Ndërsa artistët e Ansambllit shprehën se "vonesa në restaurim do të sjellë pasoja në rënien e nivelit të shfaqjeve për sezonin e ri".



Ansambli popullor, rikthen baladat, kavatë e vallet e viteve '20 në skenë

I konceptuar si udhëtimi më i ri artistik nga jugu në veri, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore do të sjellë këtë fundjavë në Teatrin e Operës dhe Baletit një mbrëmje që prej kohësh ka munguar. Ata pak kërcimtarë që i kanë mbetur ansambllit do të ngjisin në skenë baladat, kavatë dhe vallet e viteve 1920, për të vijuar me elementët më të rinj të folklorit shqiptar. Nën drejtimin e mjeshtrit të valleve, Rexhep Çeliku, solistët e Ansambllit do të përcjellin edhe materialet më të mira të konceptuara nga Festivali Folklorik i Gjirokastrës. Ky event nuk është i fundit i këtij sezoni artistik për ansamblin e valleve dhe këngëve popullore, sepse së shpejti nis rikonstruktimi i Teatrit të Operës dhe Baletit. Ansambli i Valleve dhe Këngëve Popullore ngjitet në skenë në Teatrin e Operës dhe Baletit mbrëmjen e së enjtes, më 21 maj.

"Gjuha është tepër e rëndësishme për t'ua lënë vetëm gjuhëtarëve" HEIDEGGER.

"Gjuha është pasqyra më e qartë e një kombi dhe e kulturës së tij". EQREM ÇABEJ



Shenjtërimi/ 12 vjet pas lumturimit nga Papa Pali II

Vatikani do të shpallë shenjtore Nënë Terezën

Papa Françesku ka zgjedhur 4 shtatorin, 2016, për të shenjtëruar figurën e misionares katolike shqiptare Gonxhe Bojaxhiu

DHURATA HAMZAI
TIRANE

Selia e Shenjtë e Vatikanit njoftoi se Nënë Tereza do të shpallet shenjtore më 4 shtator 2016. Papa Françesku ka zgjedhur këtë ditë për të shenjtëruar figurën e misionares katolike shqiptare, Gonxhe Bojaxhi, 12 vjet pas lumturimit të saj nga ana e Papa Gjon Palit II. Nga Selia e Shenjtë janë njoftuar autoritetet më të larta italiane për garantimin e mikëpritjes dhe sigurisë së besimtarëve të shumtë që do të jenë të pranishëm në sheshin e Shën Pjetrit, duke e konsideruar si një event botëror. Shenjtërimi i Nënë Terezës dhe mbërritja në Romë e eshtrave të Papa Piut, janë dy eventet më të rëndësishme gjatë 2016-s, vit i shpallur nga Papa Françesku si Jubileu i Jashtëzakonshëm i Mëshirës, që do të nis më 8 Dhjetor 2015 e do të përfundojë më 20 Nëntor 2016. "Bashkia e Romës ka projektuar të vërë në dispozicion rreth 500 milionë euro për të ndihmuar në rinovimin e infrastrukturës rrugore, si dhe blerjen e 400 autobusëve të rinj që do të përdoren për mikëpritjen e turistëve të shumtë që mendohet se do të vijnë për ditën e shënuar, nga Shqipëria e deri nga India, ku ka shërbyer gjatë gjithë jetës me misionin e bamirësisë, - raportojnë mediat italiane. Edhe mediat indiane i kanë bërë jehonë këtij lajmi, duke renditur dhe njëherë arritjet e saj që nga çmimi prestigjioz Nobel i Paqes në vitin 1979 dhe bëmat në të gjithë botën për punën e saj bamirëse. Nënë Tereza e Kalkutës u lumturua nga Papa Gjon Pali II, Carol Vojtila në 19 tetor të vitit 2003. Misionarja,



E djeshmja iku. E nësermja akoma s'ka ardhur. Kemi vetëm të sotmen. Le t'ia fillojmë!
NËNË TEREZA.

që emrin e lindjes e ka Gonxhe Bojaxhiu, u lind në Shkup më 26 gusht 1910. Gonxhe Bojaxhiu, u largua që në moshë të re nga familja e saj për t'u vendosur përfundimisht në Kalkuta të Indisë, ku pas drejimit të shkollës së vajzave, Nënë Tereza themeloi urdhrin "Misionaret e Dashurisë", për të cilin do të njihet më pas në mbarë botën si "Nënë Tereza e Kalkutës". Për të nderuar misionin e saj e kanë vizituar në Kalkutë dhjetëra liderë shtetesh të mëdha si ish-presidentët e Shteteve të Bashkuara George Bush, Jimmy Carter, Yasser Arafat, princesha Diana. Ndërsa Shqipëria nuk e lejoi të hynte në territorin amë, as për të qarë në varrin e nënës, deri në fillim të viteve '90, kur Nënë Tereza do të puthte e prekte tokën shqiptare.

Ajo vuri në jetë atë që dëshironte të shpërndante dashurinë e Jezu Krishtit tek njerëzit. Për këtë kontribut ndaj njerëzve, Nënë Tereza u nderua me çmimin Nobel për paqen në vitin 1979. Ky ishte momenti, kur e tërë bota do ta njihë kombësinë e saj shqiptare edhe pse vetë Nënë Tereza nuk e kishte mohuar kurrë.

"Kam lindur në Shkup, jam shkolluar në Londër, jetoj në Kalkutë dhe punoj për të gjithë njerëzit e varfër në botë. Atdheu im është një vend i vogël me emrin Shqipëri". Kështu do t'i përgjigjej Nënë Tereza një kleriku, i cili e pyeti për prejardhjen e saj. Pasi u shërbeu për një gjysmë shekulli të varfërive dhe të pashpresëve në Indi, Nënë Tereza e Kalkutës vdiq në 5 shtator 1997 në moshën 87-vjeçare. Ajo prehet në selinë e Urdhrit të Misionarëve të Bamirësisë në Kalkuta të Indisë.

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- A e do e njihnit këtë vajzë të vogël? Sot deputete e Kuvendit të Shqipërisë
- Elhaida Dani elektrizon skenën shkon në finalen e Eurovizion
- Arkat bosh, bashkiakët blerje e investime kolosale para ikjes
- Ja pasuritë e 6 ish-deputetëve makina, troje e para të deklaruar
- Përplasjet për detin, kryeministri grek Tsipras në Tiranë më 26 maj?
- E dhimbshme/ Vogëlshija pranë fotos së babaajt që s'e njohu kurrë
- Krushqija e prishur, flet Xhevria nëna e autorit të vrasjes në Kashar
- Ja Irina Shayk shumë vite më parë e varfër dhe nuk fliste me djem
- Nëna shqiptare vrau tre vajzat Gjykata: Të mbyllet në psikiatri
- Getoar Selimi me 'të kuqe' në Tiranë, shoqërohet në komisarjat

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- PD, Topollaj: Veliaj ka mashtruar kur premtoi 40000 vende pune
- Përloti Erdogan, vajza: Politikanët tanë 'të egër', reagoni i papritur
- Elhaida Dani elektrizon skenën shkon në finalen e Eurovizion
- Basha: Mbjajnë hapur universitetet publike, PD ul tarifën për studentët
- Programi i arsimit, Veliaj: Kontratë me 10 pika, jo mësim me 2 turne

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

Elhaida Dani 'elektrizon' skenën me interpretimin në Eurovizion

Gjykata refuzon kërkesën e Doshit Deputeti: Kam të dhëna për Brahon


Iir Kulla: Sulmi në Kumanovë hakmarrje për UÇK-n e dikurshme

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

SONDAZHI IDITES

A besoni se ka ardhur koha ti kerkohet Turqise mike te respektoje standardet e pakicave per rreth 5 milion shqiptaret e saj?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kampionëve të përzgjedhur në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



2.085 | 168.875
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

Teatri i Metropolit

Shfaqet "Salome", tragjedia e pasioneve të egra

Shfaqet në Teatrin e Metropolit nga qendra ACA "SALOME", një tragjedi me një akt, shkruar nga Oscar Elide. Kjo shfaqje do të ngjite në skenë në datat 20,21,22 maj në orën 20.00 për publikum, ndërsa mbrëmje u dha kjo shfaqje për të ftuar të posaçëm nga shoqëria civile dhe bota e artit dhe politikës. "Salome", kjo tragjedi e cilësuar si një nga kryeveprat e Oscar Elide provokon emocione tronditëse dhe rrenqethëse të një pasioni të pazakontë. Salome, Princesha e Judese, vajza e mbretreshës Hero-

dia, gruaja e mbretit Herod, i cili vrau vëllain dhe u martua me gruan e tij, dashurohet e fiksohet ndaj Profetit Jokanan dhe kur ai e përbuz dhe nuk e pranon, ajo duke shfrytëzuar perversitetin e Herodit që e dëshiron aq shumë Salomenë, i kërkon dhuratë koken e prerë të Jokananit. Ajo arrin deri aty sa të përkëdhel e puth me një pasion të shfrenuar kokën e prerë të Jokananit sa Herodi tmerrrohet dhe urdhëron vrasjen e Salomesë. Kjo shfaqje me Producentë Shegushe Bebetin, është vënë në skenë

nga regjizori italian Paolo Comentale, muzika Sokol Marsi, kostumografe Lucrecia Hajdari, skulptore Lucrecia Tritone dhe koreografia Fatjon Sulstarova, maskat janë punuar nga Edmond Angoni. Interpretojnë Salome-Jorida Meta, Herodi-Sokol Myzeqari, Herodia-Shegushe Bebeti, Jokanan-Florian Kokona dhe Uushtari- Fatjon Sulstarova. "Salome" është vënë në shumë skena të botës. Ricard Shtraus ka kompozuar një opera me të njëjtin titull. Al Pacino ka realizuar një film të mrekullshëm, etj.



Tirana në kaos tifoze: Largohuni dorëzoni bluzën ose iu pret druri

Ultrasit bardheblu mbyllin fushën: S'ka stërvitje, na ktheni Tironën, u mbush kupa

DYLBER BALLA TIRANE

Tirana në krizë dhe kaos. Pas largimit të trajnerit Magani, tani rrezikon të humbasë edhe tifozët, pasi besimi i bardhebluve te ekipi është në nivele minimale pas dështimit në Kupë, kampionat, por edhe pjesëmarrjes në Europë. Kjo ka bërë që tifozët të mbyllin dyert e kompleksit "Skënder Halili" në seancën e parashkuar për t'u zhvilluar të martën në orën 16:00. Tifozët pas kyçjes së portës së Skënder Halilit kishin vendosur mbi kangiella disa pankarta "Dallavere nëpër zyra, Dallavere në Pazar, Dallavere me të huaj, me Tironën ska Pazar"

"Tirana jonë, shitët fanellën. Staf, drejtues dhe lojtarë, jepni dorëheqjen", "Tirana jonë nuk shitet, jepni fanellën". Tifozët të irrituar pas dështimit u kanë bërë thirrje lojtarëve që të dorëzojnë fanellat, pasi nuk i meritojnë, teksa sipas tyre nuk janë angazhuar maksimalisht me shpirt në fushë. Dështimin në edicionin e Tiranës e shton edhe fakti që nuk arriti që të fitonte asnjë ndeshje derbi përballë Partizanit. Pas ngjarjes ka reaguar edhe klubi përmes një deklarate për shtyp të shpërndarë në rrjetet sociale. "Seanca e parë për javën e parashkuar të zhvillohet sot pasdite në "Skënder Halili" është anuluar. Tifozë bardheblu të revoltuar për mënyrën se si po mbyllet sezoni kanë mbyllur dyert e kompleksit



PROTESTA

Pankarta e tifozëve "Dallavere nëpër zyra, Dallavere në Pazar, Dallavere me të huaj, me Tironën ska Pazar" "Tirana jonë, shitët fanellën. Jepni dorëheqjen", "Tirana nuk shitet, jepni fanellën".

KLUBI

"Tirana ka mirëkuptuar këtë situatë të krijuar dhe ka anuluar stërvitjen duke i kërkuar ndjese publike tifozëve me premtimin se shumë shpejt gjërat do të ndryshojnë" thuhet nga klubi.

TIRANA

Si erdhi dështimi dhe kush është shpresa për në Europë



Tirana ishte deri në ndeshjen e 3 nga fundi në garë për titullin kampion, por barazimi me Skënderbeun 0-0 në stadiumin kombëtar në kryeqytet vrau përfundimisht shpresat e bardhebluve duke kthyer vëmendjen nga pjesëmarrja në Europë, shansi i fundit për të shpëtuar edicionin. Në Kukësi ndodhi drama më e madhe, pasi përpos faktit se humbi ndeshje dhe mundësinë për në Europë, rezultati ishte mjaft i rëndë 4-1, teksa golat i pësoi në pjesën e parë. Tronditja ishte e madhe, duke sjellë largimin e Maganit. Ndërsa në Kupë u eliminua nga Laçi, teksa tani duhet të bëjë tifo në finale që të fitojë Kukësi për të shpresuar te e vetmja rugë për pjesëmarrjen në Europë.

stërvitor për të mos lejuar zhvillimin e përgatitjeve. KF Tirana ka mirëkuptuar këtë situatë të krijuar dhe ka anuluar stërvitjen duke i kërkuar ndjese publike tifozëve me premtimin se shumë shpejt gjërat do të ndryshojnë". Vendimi i tifozëve të klubit i ka vendosur drejtuesit e ekipit të Tiranës në një pozicion shumë të vështirë, pasi po kërkojnë që të zgjidhin gjithçka me diplomaci, pasi tifozët kanë dhënë një mbështetje maksimale duke e ndjekur ekipin në çdo sfidë brenda dhe jashtë qytetit në çdo kohë dhe moment. Por, radhë dhe ndoshta asnjëherë në botë nuk ka ndodhur që tifozët të bllokojnë aktivitetin sportiv të ekipit. Presidenti Refik Halili e parandjeu një gjë të tillë teksa të hënën në mbërrimje përmes një

letre të hapur u kërkonte ndjesë të gjithë tifozëve për dështimin. Sipas Halilit, tre ishin shkaqet që sollën dështimin: Mungesa e mentalitetit fitues, organizimi dhe shpirti fitues. Por as ndjesa nuk e bindi tifozerinë. Nuk kanë munguar as komentet në Facebook, teksa disa kërkojnë largimin e futbollistëve të huaj. Ndërsa të tjerët, shprehen "Na mytet ne premtime. Na ktheni Tironën. Shkurt muhabeti, dume Tironen si m'vaktit i'El Samedit". Ndërsa situata agravohet edhe më keq në komente, teksa njëri prej tyre me emrin "Xheki K" shkruan "Me keq do shkoje, nuk e kon provu se dime ca domethene ti thysh makinat dhe dru ti rrafesh. U mush kupa nuk ba mo uji pilafi. Te ngrehemi te gjithë se shume i kemi perkedhel".

LAJME SHKURT



Skandali i trukimeve në Itali, 50 në pranga, mes tyre 2 shqiptarë

Dy shqiptarë të përfshirë në trukimet e ndeshjeve në Itali janë mes 50 të arrestuarve për një tjetër skandal në futbollin italian. Edmond Nerjaku dhe Erikson Aruçi futbollist janë në mesin e 50 të arrestuarve. Ndeshjet e trukuara janë të kategorive Lega Pro dhe Serie D. Policia ka ndërmarrë një aksion të gjerë për të zbatuar një seri urdhër-arrestesh të lëshuar nga prokurorët e Antimafias në Katanzaro të Kalabrisë. Janë 50 persona të arrestuar, mes të cilëve presidentë dhe drejtues klubesh, lojtarë e të tjerë, ndërkohë që 80 janë personat e përfshirë në hetimin e Antimafias që ka në bazë një familje mafioze kalabreze.

Fusha, FSHF inspekton gjendjen e Tërbunit dhe Bylisit: S'ka tolerime

Pas përfundimit te sezonit 2014-2015 për Kategorinë e Parë, Tërbuni fitues i grupit A dhe Bylis fitues i grupit B, ka filluar inspektimi nga një grup pune për gjendjen e stadiumeve. Dje ky grup pune ka qenë në stadiumin "Ismail Xhemali" të Pukës dhe sot do të vazhdoje me inspektimin në stadiumin "Adush Muca" te Bylis. Sektori i Licencimit do të bëjë kontrollin e infrastrukturës, kushteve ligjore dhe administrative për të dyja klubet që do të ngjiten. FSHF është e vendosur që te mos tolerojë asnjë klub pa plotësuar kriteret e licencimit, infrastrukturor, administrative dhe ligjore.



Milani, gjenerata më e padisiplinuar Galiani: Prisni një verë të nxehtë

Futbollistët e Milanit në sezonin aktual janë ndëshkuar me 12 karton të kuq. Në këtë mënyrë u bënë gjenerata më e padisiplinuar ndonjëherë në një sezon. Milanezët kanë patur një nga sezonet më të këqija. Dy xhiro para fundit të kampionatit italian në futboll ndodhen në pozitën e 11-të të tabelës me vetëm 46 pikë. E pabesueshme, por e vërtetë, "rosonerët" pas liderit Juventus, dhe rivalit më të madh Inter, kanë mbetur mbrapa për 37 pikë të pabesueshme. Por administratori Galiani ka premtuar një verë të nxehtë duke paralajmëruar blerje të mëdha për ringritjen.

Kriza, Presidenti Perez: Reali i Madridit nuk ka kufij

Presidenti i Realit të Madridit, Florentino Perez gjatë prezantimit të aplikacionit të ri të Realit të Madridit për telefonat deklaroi se "Real nuk dorëzohet kurrë, do të provojë gjithçka dhe do të punojë pa u lodhur për ta sjellë trofeun e 11 të Champions League, si ekipi i basketbollit që u shpall për herë të 9 kampion i Europës. Ne duam që te jemi të afërt me të gjithë ata për të cilët Real Madridi është një nga emocionet më të rëndësishme të jetës së tij. Ky klub nuk ka kufij dhe Real Madridi është një ndjenje që lidh miliona tifozë" deklaroi ai.

Finalja e Kupës Lazio-Juve, Berisha titullar në portë

Trajneri i Lazios, Stefano Pioli ka konfirmuar se Etrit Berisha do të jetë gardian i portës, në finalen e Kupës përballë Juventusit. Lazio dhe Juventus sot do të kërkojnë titullin e Kupës së Italisë. "Berisha do të jetë në portë për Kupën, Marchetti është portier në Serie A. Ne kemi

dy portierë të mrekullueshëm", tha trajneri Pioli. Lazio do të tentojë që të mbyllë edicionin në mënyrën më të mirë pas kualifikimit në Champions League, ndërsa Juventus synon tripletën, pasi fitores së kampionatit dhe sigurimit të finales së Berlinit më 6 Qershor përballë Barcelonës.



Klopp te Reali i Madridit Anceloti mes Milanit e City


Jurgen Klopp do ta drejtojë Real Madridin në tre vjetet e ardhshme, sipas një radio gjermane, por ende asgjë zyrtare nga trajneri dhe klubi spanjoll. Klopp do të drejtojë Realin pas një marrëveshjeje 3-vjeçare duke zëvendësuar Carlo Ancelottin. Ndërsa e ardhmja e Ancelotit lidhet me

Cityn ose Milanin me sponsorët e rinj. Duke ju referuar asaj që bëri të ditur Radio Deutschland, akordi do të zyrtarizohet pas 30 Majit, datë në të cilën Klopp do të drejtojë për herë të fundit Borussia dhe Dortmundin në finalen e Kupës së Gjermanisë përballë Wolfsburgut.

NGA **Kadri VOKOPOLA**




FJALËKRYQI PA SKEMË DUHET TË NXINI 39 KUTI



HORIZONTAL


- Gustav kompozitor.
- Duhet vrarë në luftë.
- Klikohen me mouse
- Rrëhim në qendër.
- Howard regjisor
- Fillojnë matjet.
- Te parat në atletikë.
- Shtirret pa fund një e tillë në Rusi
- Gjysmë dhallë.
- Kush ka... ka zë.
- Një Santa në New Mexico.
- Një rakete amerikane.
- Ka brirë piktoreskë.
- Eshhtë ai që kërkon të poste drejtuese.
- Një mund të jetë artistik.
- Aspak konkrete.
- Iniciale e Stone regjisor.
- Harris shkrintar.
- Moretini i Komisarit Rex
- Kush është nuk tutet
- Nuk ka harbuti.
- Në krye të tradhtarëve.
- Teket e një trupe.
- Ushtria republikane irlandeze.
- Asne, as ju
- Fundi i një fundi.
- Gjysmë piloti.
- Të parat në orkestër.
- Gjysmë kolege
- Fillojnë rubrikën.
- Një... Ço! Jo Coca.
- Organisnjë atentate më Afganistan të tillë.
- Eric Rohmer.
- Një turk i sulltanit.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË




- Eshhtë dhomë e lartë.
- 12. Alpha... në Aldebaran.
- Studjoni alenët.
- Janë në masë.
- 5. Hapet me pe.
- Ai i kuq u hap për hebrejtë.
- 6. Kufizojnë lëvizjet.
- Një makinë italiane.
- 7. Fillojnë seftë.
- Gjysma e borsë.
- Samiu pa cifte.
- 8. Një mund të jhetë fetar.
- Klube Sportive Bulgare.
- Edith e Millord.
- 9. Ai D'prek mëlçinë.
- Në krye të notarëve.
- 10. Charles që krijoi Gishton.
- 11. Ka një mangët i luajturi.
- Pason pa kufij.
- 12. Mbyllin një sirtar.
- Gjysmë siklet.
- Blokshin trainer ukrainas.
- Një mund të jetë cirku.
- Një pjesë e baterisë.
- 15. Eshhtë shtet aziatik.
- Janë si baba.
- 16. Knock Out.
- Iniciale e Sand shkrintare.
- Mund të jetë hollë dhe therëse.
- 17. Një... italian
- Janë Dajti dhe Korabi

FJALËKRYQI SPORTIV



PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV




HORIZONTAL

- Navratlova e tenisit.
- Parer regjisor.
- King Cole i muzikës.
- Personazhi në foto.
- Mbyllin portat.
- Fagë që që basketbollist.
- Fillojnë natën.
- Lendi ish-tenist.
- Fillojnë rishitas.
- Nxjerin nusen me ne.
- Skudra merengue.

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË
MËNYRË QË ÇDO RRESHT E
KOLONË TË KETË NUMRAT NGJA 1-9



HOROSKOPI

DASHI

Do kaloni shumë vështirësi sot juve që jeni në një lidhje dhe here pas here do kërkoni ndihmë nga iltas familjare. Beqaret do jeni gati të pranohen në fruse që do ju bëhet dhe do fillojnë menjëherë një lidhje serioze. Do e ndryshojnë me në fund statusin. Financat do i menaxhoni me kujdes dhe maturi prandaj situata do mbetet e qëndrueshme. Vazhdoni me këtë sjellje.

DEMI

Do jeni shumë kureshtar gjatë kësaj dite dhe do i kërkoni partnerit të provoni eksperiencën e reja. Ajo vetëm që do ua plotësojë dëshirat, por do ju bëjë të ndihni si mbi re. Beqaret nuk duhet të nxihen sepse do bëjnë gabime të pafalshme. Në planin financiar vjet do ndikojnë pozitivisht dhe do jua bëjnë të shini gjerat me optimizëm. Do jeni me të qete kur të shpenzoni.

BINJAKËT

Dialogo do jete shume i forte gjate gjithë kësaj dite për juve që jeni në një lidhje dhe gjithçka ka për të ecur mire me atë që keni në kra. Beqaret do bëjnë atë që do ju thotë zemra dhe do ndihen me në fund mire. Do e kuptojnë me në fund se çfarë do të thotë të jesh çift. Financat nuk do jeni në gjendjen me të mire të mundshme kështu që mire është të mendoheni para se të shpenzoni.

GAFORRJA

Do merreni me tepër me jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite dhe do i zgjidhni shpejt edhe mosmarrëveshjet që ju kishin dale. Beqaret do kenë një dite me të veçante se me parë dhe të mbushur plot me takime impresionuese. Shfrytëzojeni sa të mundni! Edhe për të riorganizuar financat kjo do jete një dite e begate. Do jeni me fat dhe gjendja do përmirësohet.

LUANI

Plutoni do jete planeti që do ndikojë pozitivisht sot në jetën tuaj sentimentale. Kënaqësitë dhe emocionet do jete në paimagjinueshme. Disa majo mund të ndihni gati edhe për të marre vendime. Beqaret do vazhdojnë të mbeten vetëm edhe për disa kohe. Në planin material Merkuri do ju ndihet të tregoheni të arsyeshëm. Nuk do kryeni aspak shpenjete të pamenduara.

VRIGJËRESHA

Do ndërtoni me shume nga sa duhet sot juve që jeni në një lidhje dhe realiteti do ju duket paksa i hidhur. Asgjë nuk do shkoje ashtu si keni dëshiruar. Beqaret me në fund do kenë dashuri me shikim të parë dhe do fillojnë një lidhje afatgjate. Në planin financiar do jeni kapriceoze dhe të pamatur. Ka rrezik që gjendja të ketë tronditje serioze kësaj here.

PESHORJA

Dielli do e nrohet tëpë masë sot jetën tuaj në çift. Do jeni me të lirshëm për të folur edhe për disa tema delikate të cilat me parë as që i keni prekur. Beqaret nuk duhet të ndërmarrin rreziqe vetëm për ta gjetur princin e kaltër. Me mire t'i lënë gjerrat të rrjedhin natyrshëm. Në planin financiar do i rregullojn gjerrat me në fund dhe do ndihni me të qete se me parë.

AKREPI

Here do gëzoheni e here do dëshpëroheni sot juve që jeni në një lidhje. Asgjë nuk ka për t'u ecur ashtu si keni dëshiruar. Shmangni sa të mundni marrjen e vendimeve. Beqaret do fillojnë me në fund një lidhje të qëndrueshme dhe afatgjate. Në planin financiar do jeni shume të matur dhe nuk do kryeni shpenjete të pamenduara. Gjendja do jete e kënaqshme.

SHIGJETARI

Dite e begate dhe plot dielli gjithë sotja për ata që jeni në një lidhje. Do keni një komunikim të ngrohtë dhe partnerit dhe gjithçka do ece si e keni dëshiruar gjithmonë. Beqaret do jete të paduror dhe mund të hedhin hapa të gabuara gjatë kësaj dite. Mund të jete në këmbë, megjithatë mire është të mos nxiteni kur të shpenzoni. Tregohuni të kujdesshëm.

BRICJAPI

Planetët do jete të pozicionuar mire sot në jetën tuaj në çift dhe do ju drejtojnë në rrugën e duhur. Çdo gjë do jete me e bukur se kurrë me parë. Beqaret do ja kushtojnë gjithë ditën familjareve dhe nuk do mendojnë aspak të kërkojnë dashuri. Në planin financiar do jeni probleme serioze nëse tregoheni impulsive dhe kryeni shpenjete të pamenduara.

UJORI

Dite e këndshme edhe pse ju me emocione shume të fuqishme kjo sotja për të dashuruarit. Merrni gjerrat shtuar. Beqaret do jete me një shume fat në kurrë me parë. Jo vetëm që do kenë takime mbresëlënëse, por mund të fillojnë edhe një lidhje të kënaqshme. Teardhurat do përmirësohen akoma edhe me tepër falë një ndihme të konsiderueshme që do merri nga familjarët.

PESHQIT

Rutina do e pushtojë sot jetën tuaj në çift dhe here pas here do ndihni kee pranë partnerit. Mundohuni sa të mundni ta ndryshoni situatën sepse ne të kundërt gjerrat do përkeqësohen. Beqaret do qëndrojnë vetëm me miqtë dhe nuk do kenë fat në dashuri. Financat do varen tërësisht nga mënyra sesi ju do i menaxhoni. Po shpenzatu kuturo do keni edhe probleme.

[SHQIPTARJA.com]

me imazh të ri...

Më në fund
një gazetë e pavarur



Gazeta siç e duan
shqiptarët!

Shikoni gazetën e re këtu

